



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**NR. 32 AKTI**

**NR. 58 VENDIMI**

**Tiranë, më 01.08.2018**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Lulzim Hamitaj</b>	Kryesues
<b>Olsi Komici</b>	Relator
<b>Brunilda Bekteshi</b>	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier Demongeot, në Tiranë, më datë 30 korrik 2018, ora 14:30, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Besnik Muçi**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë për Krime të Rënda Tiranë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”; **Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; **Ligji nr. 44/2015** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; **Ligji nr. 49/2015** “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, z. Besnik Muçi, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e tij në seancë dëgjimore publike vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Besnik Muçi, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

## VËREN:

### I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Muçi, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit, duke qenë kandidat për anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë të nenit 279 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 30.11.2017, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit” nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, short nga i cili rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 3, i përbërë nga komisionerët Brunilda Bekteshi, Lulzim Hamitaj dhe Olsi Komici. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Olsi Komici.

Me vendimin nr.1, datë 14.12.2017, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Besnik Muçi, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit, anëtarin Lulzim Hamitaj. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes.

Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Ferdinando Buatier Demongeot.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet:1) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); 2) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe 3) Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme.

Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të hetimit administrativ.

ILDKPKI, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>1</sup>, duke konkluduar se:

1. Deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;
2. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
3. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
4. Nuk ka kryer deklarim të rremë;
5. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë

<sup>1</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.11.2017, e përbërë nga 16 fletë, është dërguar raporti i ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, dhe ka dërguar një raport të arsyetuar<sup>2</sup>, duke konkluduar mbi “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Muçi.”

Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>3</sup> mbi subjektin e rivlerësimit.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe nga studimi i çështjes, është konkluduar në tërësi se:

*“Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit është konstatuar se subjekti ka ka burime të ligjshme financiare; nuk ka kryer fshehje të pasurisë; nuk ka kryer deklaram të rremë; nuk është në kushtet e konfliktit të interesit..*

*Nga hetimi mbi pastërtinë e figurës, nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë mbi përfshirje të mundshme të subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive, për shkak të funksionit apo ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.*

*Nga hetimi i aftësive profesionale, pasi u hetua raporti i Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme dhe denoncimet, subjekti i rivlerësimit u gjet “i aftë”, duke treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, dhe duke qenë eficient dhe efektiv në masë të pranueshme”.*

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 18.07.2018 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Besnik Muçi, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua më datë 18.07.2018 mbi përbërjen e trupit gjykues, mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë në rrugë elektronike, më datë 25.07.2018.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 30.07.2018, ora 14:30, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier Demongeot.

<sup>2</sup>Me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 27.10.2017, dërgohet raporti i DSIK-së për subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

<sup>3</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.12.2017, dërgohet raporti i Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht. Ai parashtroi shpjegimet e tij në seancë, si dhe i depozitoi ato me shkrim pranë Komisionit.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

### **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Z. Besnik Muçi ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Muçi, është prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për këtë subjekt përfshin: (1) vlerësimin e pasurisë, (2) kontrollin e figurës dhe (3) vlerësimin e aftësive profesionale.

Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016 2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

#### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

##### **Mbledhja e informacioneve dhe provave për vlerësimin e pasurisë**

Bazuar në ligjin nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i pëmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Referuar neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) Provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”, shtojca 2;
- b) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) Provat shkresore/dokumentet, të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, si nga Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Banka e Shqipërisë dhe banka të nivelit të dytë, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtoritë rajonale të tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., shoqëria “Ujësjetllës-Kanalizime” sh.a., zyra noteriale, etj.

- ç) Deklarime dhe prova të dërguara nga subjekti me anë të komunikimit elektronik;
- d) Shpjegimet me shkrim të subjektit, si dhe shpjegimet në seancën dëgjimore.

Pas verifikimit administrativ të kryer nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, si edhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Besnik Muçi, rezulton se:

Në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 25.01.2017, subjekti deklaroi këto pasuri:

**1. Tokë truall, me sipërfaqe 366 m<sup>2</sup>, i ndodhur në \*\*\*, Pogradec. Marrë nga shteti pa shpërblim, në vitin 1991.**

### Hetimi i kryer nga Komisioni

Komisioni ka kryer hetim të thelluar në lidhje me këtë pasuri, nga ku rezultoi se:

- Nga korrespondenca e kryer me ZVRPP-në Pogradec<sup>4</sup>, për pasuri të paluajtshme të regjistruara në emër të subjektit dhe personave të lidhur, konfirmohet se në emër të z. Besnik M. Muçi figuron e regjistruar pasuria me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK \*\*\*, fshati \*\*\*, “truall”, me sipërfaqe 366 m<sup>2</sup> dhe “ndërtesë” me sipërfaqe 99 m<sup>2</sup>.
- I është kërkuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Pogradec dhe Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP) Tiranë<sup>5</sup> praktika e plotë e regjistrimit dhe çdo transaksion për pasurinë e paluajtshme të sipërcituar, si dhe një kopje e listës së trojeve (001) të fshatit \*\*\*, Pogradec.
- Nga korrespondenca e kryer me Bashkinë Pogradec<sup>6</sup> konfirmohet se z. Besnik Muçi është shkëputur nga trangu familjar i përfaqësuesit të familjes bujqësore me Vendim të Këshillit \*\*\* nr. \*\*\*, datë 30.09.1993, duke bashkëngjitur dhe certifikatat përkatëse.
- Me qëllim verifikimin e vërtetësisë së listës emërore të pronarëve të trojeve dhe shtëpive të fshatit \*\*\*, nga Bashkia Pogradec, Njësia Administrative \*\*\*, është përcjellë në Komision lista e trojeve të fshatit \*\*\*, gjithsej 19 fletë, e cila rezultoi të jetë e njëjtë me atë të dërguar nga ZVRPP-ja Pogradec.

Për pasurinë e paluajtshme të llojit “truall”, me sip. 366 m<sup>2</sup>, të deklaruar në deklaratën “Vetting” si të marrë nga shteti, pa shpërblim, në vitin 1991, në cilësinë e përfaqësuesit të familjes bujqësore, është pyetur subjekti si më poshtë:

- *“Cila është mënyra dhe dokumenti ligjor në bazë të të cilit jeni bërë pronar i kësaj pasurie kur më 01.08.1991 keni qenë anëtar i familjes bujqësore ku përfaqësues i saj ka qenë babai juaj, z. M. M?”*

Pas konstatimit nga Komisioni të faktit se këtë pasuri subjekti e ka deklaruar si të llojit “truall”, me sipërfaqe 366 m<sup>2</sup>, por nuk ka deklaruar “ndërtesë” me sipërfaqe 99 m<sup>2</sup>, në përfundim të

<sup>4</sup>Shiko për më tepër shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 05.01.2018, drejtuar ZVRPP-së Pogradec dhe përgjigjen e ardhur me shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 11.01.2018, dhe nr. \*\*\* prot., datë 11.01.2018.

<sup>5</sup>Shiko në dosje shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 28.02.2018, drejtuar ZVRPP-së Pogradec dhe ZQRPP-së Tiranë, si dhe përgjigjen e ardhur me nr. \*\*\* , datë 08.03.2018, dhe nr. \*\*\* , datë 08.03.2018.

<sup>6</sup>Shiko për më tepër në dosje shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 05.04.2018, drejtuar Bashkisë Pogradec dhe përgjigjen e ardhur me nr. \*\*\* prot., datë 11.04.2018.

korrespondencës me Bashkinë dhe ZVRPP-në Pogradec, nga Komisioni i është bërë pyetje subjektit (pyetëtori nr. 3), si më poshtë:

- *“Si e keni përfutuar truallin me sip. 366 m<sup>2</sup> në një kohë kur nuk keni pasur shtëpi banimi të ndërtuar mbi të dhe keni qenë në të njëjtin trung familjar me përfaqësuesin e familjes bujqësore, z. M. M, i cili gjithashtu ka deklaruar pasurinë (pasuria nr. 224/5 e llojit “truall” me sip. truall 300 m<sup>2</sup> dhe sip. ndërtimi - 160 m<sup>2</sup>) në emër dhe pronësi të familjes bujqësore?”.*

Në përgjigjen e tij më datë 19.04.2018<sup>7</sup>, subjekti deklaroi: *“Kjo sipërfaqe toke është ndarë nga organet e pushtetit lokal në vitin 1991. Pas banesës sonë në fshatin \*\*\*, pushteti lokal ndau sipërfaqe toke për ndërtim për familjet. Një ngastër e tillë prej 366 m<sup>2</sup> i është dhënë dhe familjes sime dhe, konkretisht, më është dhënë mua për të ndërtuar shtëpi. Për këtë tokë janë kryer nga shteti edhe veprimet e regjistrimit në ZVRPP-në Pogradec në vitin 1996. Kjo vërtetohet me dokumentin arkivor të ZVRPP-së Pogradec, lista e trojeve të ndara. Duke qenë se unë vazhdova studimet e larta e më pas Shkollën e Magjistraturës dhe nuk u ktheva të jetoja në fshat, nuk ndërtova shtëpi në këtë tokë, e cila dhe sot e kësaj dite është e lirë.*

*Në ZVRPP ka rezultuar se ka ndërtesë 99 m<sup>2</sup>, por ky fakt nuk përputhet me gjendjen reale dhe vlerësoj se mund të ketë ardhur si rrjedhojë e faktit se ZVRPP-ja Pogradec së bashku me pushtetin lokal kanë bërë regjistrimin e kësaj prone në vitin 1996 mbi bazën e listës së trojeve për shtëpi që ka ndarë pushteti lokal në vitin 1991, ku kjo pronë është dhënë për ndërtim. Unë nuk kam nënshkruar në asnjë nga dokumentet e ndarjes apo regjistrimit të kësaj prone.*

*Këtë pronë e kam deklaruar si truall dhe nuk kam pasur dijeni për këtë fakt, çka provohet nga kartela e pasurisë, pasi nuk kam kryer transaksione mbi këtë pronë.*

*Pas marrjes së pyetjeve nga ana Juaj, kam aplikuar në ZVRPP Pogradec dhe në përgjigjen e saj nr. 1007 datë 11.04.2018, më është komunikuar se në truallin që unë disponoj është një ndërtesë 99 m<sup>2</sup>.”*

Subjekti vazhdon deklarinimin se pas korrespondencës me Komisionin, ai ka aplikuar në ZVRPP-në Pogradec dhe në Bashkinë Pogradec për të filluar procedurat për korigjimin në ZVRPP nga pasuri “truall” dhe “ndërtesë” në pasuri “truall”, dhe e gjithë kjo iniciativë e subjektit vetëm pas hetimit dhe konstatimit nga Komisioni.

Subjekti i ka bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit të depozituar në Komision më datë 20.04.2018, me nr. \*\*\* prot., kopjen e kartelës së pasurisë lëshuar nga ZVRPP-ja Pogradec më datë 17.04.2018, për pasurinë në pronësi të tij me nr. \*\*\*, të regjistruar në ZK \*\*\*, \*\*\*, Pogradec, të llojit “truall”, tashmë të korigjuar, me sipërfaqe totale të pasurisë 366 m<sup>2</sup>, po aq edhe truall, por pa sipërfaqe ndërtesë të pasqyruar në të, korigjuar me dokumentin me nr. reference \*\*\*, datë 16.04.2018.

Në shpjegimet e dërguara në Komision nga ana e subjektit më datë 25.07.2018, pas kalimit të barrës së provës, ai sqaron se: *“Nuk kemi të bëjmë me pasuri të fituar në mënyrë të paligjshme. Kjo parcelë ka qenë pronë e ish-kooperativës bujqësore dhe gjatë procesit të ndarjes së tokës, në vitin 1991, nga Komisioni i Ndarjes së Tokës Bujqësore të fshatit \*\*\*, bashkë me një parcelë tjetër, nuk u janë ndarë familjeve bujqësore me qëllim ndarjen e saj në një moment të dytë në troje për ndërtim, sipas nevojave që do të kishin familjet. Më pas, kjo parcelë është ndarë në 19 parcela trojesh për ndërtim të banorët që kishin nevojë, ku njëri prej tyre isha edhe unë. Gjithashtu, nuk qëndron konstatimi i Komisionit se kjo parcelë është ndarë në kundërshtim me ligjin nr. 7512, datë 10.08.1991, dhe VKM-në 432, datë 14.08.1995, që trajton regjistrimet e truallit vetëm në funksion të një ndërtimi ekzistues para vitit 1991 dhe jo të një truall pa*

<sup>7</sup> Shiko në dosje përgjigjen e pyetësorit, datë 19.04.2018, faqe 1.

*ndërtim, sepse deri në vitin 1991 e gjithë parcela e mësipërme ka qenë tokë bujqësore dhe është ndarë për truall.”.*

Për të konfirmuar sa më sipër, subjekti u ka bashkëlidhur shpjegimeve të dërguara në Komision më datë 25.07.2018 deklaratat e shtetasve H. B (*ish-kryeplaku i fshatit \*\*\**), A. B, H. M, N. I, D. B, D. Ç.

- *Në lidhje me pyetjen drejtuar subjektit për arsyen e mosdeklarimit të truallit me sipërfaqe 366 m<sup>2</sup> në deklaratat e pasurisë në vitet 2003, 2004 dhe 2005.*

Subjekti sqaron se mosdeklarimi nuk është bërë për ndonjë arsye apo qëllim të caktuar, por është deklaruar pas konsultimeve dhe sugjerimeve me specialistë të ILDKPKI. Gjithashtu arsye tjetër është edhe fakti se kjo pasuri është shfrytëzuar nga familja bujqësore e babait tim dhe se subjekti nuk ka përfituar asnjëherë fruta civile nga këto prona.

Në seancën dëgjimore, nga ana e subjektit u argumentua se kjo pasuri nuk ka lidhje me veprimtarinë e tij si prokuror dhe se, nga ana e tij, asnjëherë nuk ka pasur interesim se si është regjistruar kjo pasuri në ZVRPP-në Pogradec, nuk ka tërhequr dokument pronësie dhe se nuk ka pasur përfitime nga kjo pasuri.

#### ❖ **Arsyetimi ligjor**

Në dokumentacionin shoqëruar të deklaratës “Vetting”, dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI sipas inventarit të datës 26.01.2017, nr. extra prot., është depozituar kartela e pasurisë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK \*\*\*, fshati \*\*\*, të llojit “truall”, me sipërfaqe 366 m<sup>2</sup> dhe “ndërtesë” me sipërfaqe 99 m<sup>2</sup>, e lëshuar nga ZVRPP Pogradec më datë 15.02.2016, por subjekti i rivlerësimit nuk ka aplikuar dhe nuk ka tërhequr certifikatën për vërtetim pronësie për këtë pasuri në ZVRPP-në Pogradec.

Pavarësisht mënyrës së pasqyrimin të kësaj pasurie në regjistrat e kartelave të pasurive në ZVRPP-në Pogradec dhe korrigjimeve të mëvonshme të kryera me kërkesë të subjektit, kjo pasuri ka kaluar në pronësi të subjektit nga institucionet shtetërore të kohës në kundërshtim me ligjin 7512, datë 10.08.1991, “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, i ndryshuar, neni 21, ku përcaktohet se: *“Personave fizikë a juridikë privatë vendas u jepet në pronësi truall për ndërtim me pagesë, duke pasur edhe të drejtën e shitblerjes”* dhe VKM-në nr. 432, datë 14.08.1995, “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit”, që trajton regjistrimet e truallit vetëm në funksion të një ndërtimi ekzistues para datës 10.08.1991 dhe jo të një trualli pa ndërtim mbi të.

Pasuria e sipërcituar, megjithëse për të ka përfunduar procesi i regjistrimit fillestar në zbatim të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, dhe ajo figuron e regjistruar në ZVRPP-në Pogradec që në datën 01.11.1996, nuk është deklaruar në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie të vitit 2003 dhe në deklaratat e interesave private periodike/vjetore për vitet 2004 e 2005, por fillon të deklarohet nga subjekti në vitin 2006, si *“tokë truall, 400 m<sup>2</sup>, marrë nga shteti, pa shpërblim, në 1991”*. Gjithashtu, kjo pasuri është deklaruar nga subjekti edhe në deklaratën “Vetting”.

Nga Komisioni konstatohet se pasuria e sipërcituar është përfituar nga subjekti dhe rezulton e regjistruar në ZVRPP-në Pogradec përpara se ai të ketë filluar ushtrimin e detyrës së prokurorit, çka do të thotë se përfitimi i kësaj pasurie nuk është rrjedhojë e ndonjë ushtrimi të ndikimit të

paligjshëm të subjektit për shkak të detyrës apo edhe përfitim e saj me burime financiare të paligjshme. Pavarësisht përfitimit të kësaj pasurie nga subjekti në kundërshtim me ligjin dhe pamundësisë së tij për të shpjeguar bindshëm ligjshmërinë e këtij përfitimi, Komisioni, në analizën e tij ka mbajtur në konsideratë parimin e proporcionalitetit sipas përcaktimit në nenin 4, pika 5 të ligjit 84/2016 duke vënë në balancë, pasurinë, kohën e përfitimit të saj, statusin e subjektit në atë kohë dhe veprimet aktive/joaktive të subjektit për fitimin e kësaj pasurie.

Në lidhje me konstatimin e mosdeklarimit nga subjekti të pasurisë së sipërcituar, në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie të vitit 2003 dhe në deklaratat e interesave private periodike/vjetore për vitet 2004, 2005, por fillon të deklarohet nga subjekti në vitin 2006, si dhe është deklaruar në deklaratën “Vetting” sipas të dhënave të pasurisë që rezultojnë në regjistrat e pasurive në ZVRPP-në Pogradec - ky mosdeklarim ndër vite potencialisht mund të përbënte kundërvajtje administrative sipas ligjit të kohës për deklarimin e pasurisë. Por, në një analizë referuese të nenit D i Kushtetutës dhe nenet 33 dhe 61 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni arsyeton se deklarata bazë e procesit të rivlerësimit të pasurisë është deklarata “Vetting”, subjekti nuk ka kryer fshehje të pasurisë, deklarim të rremë dhe as nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit e, për rrjedhojë, nuk mund të konkludohet për shkelje ligjore që çojnë në shkarkimin e subjektit nga detyra.

## **2. Tokë bujqësore, me sipërfaqe 2000 m<sup>2</sup>, ndodhur në \*\*\*, Pogradec, marrë nga shteti pa shpërblim, në vitin 1991, sipas ligjit nr. 7501 “Për tokën bujqësore”.**

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Në deklarimin e pasurisë para fillimit të detyrës, viti 2003, subjekti deklaroi 10 000 m<sup>2</sup> tokë bujqësore. Pjesa që zotëron: 20 %. Burimi: Përfitur në bazë të ligjit 7501/1991 “Për Tokën.

- Nga korrespondenca me ZVRPP-në Pogradec<sup>8</sup> rezultoi se në emër të shtetasit M. M, janë të regjistruara 5 pasuri të llojit “arë”, me sipërfaqe totale sipas matjeve të pasqyruara në librin e ngastrave 8.640 m<sup>2</sup>, si dhe një pasuri e llojit “truall”, me sipërfaqe truall 300 m<sup>2</sup>, dhe sipërfaqe ndërtese 160 m<sup>2</sup>. Bashkëlidhur ndodhet akti i marrjes së tokës në pronësi (AMTP), me nr. \*\*\*, datë 02.04.1997, në emër të M. M.
- Është pyetur subjekti në lidhje me këtë fakt dhe në përgjigjen e tij ai sqaron se: *“Pjesa e përfitur nga ai në përpjesëtim me sipërfaqen totale të pasurisë së përfitur me ligjin 7501 është 2600 m<sup>2</sup>. Kur ka deklaruar sipërfaqen prej 2000 m<sup>2</sup>, nuk është konsultuar me AMTP-në. Babai i konfirmon se kanë marrë nga shteti 2000 m<sup>2</sup> për frymë. Kjo përgjigje mund të ketë ardhur edhe për shkak se një sip. prej 3000 m<sup>2</sup> nga kjo tokë e përfitur si familje bujqësore nuk është punuar asnjë vit, sepse ishte kodrinore dhe nuk mund të vaditej e për rrjedhojë ishte pa rendiment. Kjo pjesë është e paregjistruar në ZVRPP-në Pogradec”.*

### **❖ Arsyetimi ligjor**

Si konkluzion, nuk ka dyshime mbi këtë pasuri dhe deklarimi i subjektit është i saktë. Sipas certifikatës së lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile \*\*\* (dërguar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 09.03.2018), familja e z. M. M, në datën 01.08.1991 ka qenë e përbërë prej 5 anëtarësh, ku njëri prej tyre rezultoi të jetë subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Muçi. Në bazë të VKM-së nr. 255, datë 02.08.1991, “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, pika 2, citojmë: *“Në të gjitha*

<sup>8</sup>Shiko për më tepër shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 05.01.2018, drejtuar ZVRPP-së Pogradec dhe me përgjigjen e ardhur me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.01.2018, dhe nr. \*\*\* prot., datë 11.01.2018.



*rastet toka ndahet përpjesëtimisht për çdo familje, sipas numrit të frymëve të gjendjes civile në datën 1 gusht 1991*". Për rrjedhojë, njëri nga përfituesit e tokës bujqësore si anëtar i familjes së z. M. M ka qenë edhe subjekti Besnik Muçi, i cili ka përfituar 1/5-tën ose 20 % të sipërfaqes së tokës bujqësore të pasqyruar në aktin e marrjes së tokës në pronësi. Çdo pasaktësi në deklarinimin e sipërfaqes është e karakterit objektiv, që vjen si rrjedhojë e pasaktësive në matje, jo për faj të subjektit.

**3. Shtëpi banimi, apartament me sipërfaqe 57 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, zona kadastrale nr. \*\*\*, Rruga "\*\*\*\*", pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë. Blerë me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep. dhe \*\*\* kol., datë 07.01.2006. Vlera 1.900.000 lekë.**

**Burimi i krijimit:**

- Kursime nga rroga, 200.000 lekë.
- Hua M. M (*babai i subjektit*) 500.000 lekë, kursime nga emigracioni në Greqi dhe puna në bujqësi.
- Hua B. C dhe M. C (*bashkëshortë, dhëndri dhe motra e subjektit*) shuma 6.000 euro kursime nga puna në emigracion në Angli.
- Hua H. M (*xhaxhai i subjektit*) 3.000 euro, kursime nga emigracioni në Greqi dhe puna në bujqësi.

**Hetimi i kryer nga Komisioni**

Rezulton se për herë të parë ky apartament banimi është deklaruar nga subjekti në deklaratën e interesave private periodike/vjetore të viti 2006, ku janë specifikuar edhe burimet e krijimit të përmendura më sipër.

ZVRPP-ja Tiranë<sup>9</sup> konfirmon pasurinë apartament me të dhënat e mësipërme në pronësi të subjektit, z. Besnik M. Muçi.

Në lidhje me huat e marra, subjekti ka depozituar si dokumente justifikuese në dosjen "Vetting" deklaratat me shkrim dore nga personat e mësipërm që konfirmojnë dhënien e këtyre huave:

- a) Deklaratë e z. M. M, pa datë, ku konfirmon dhënien borxh Besnik Muçit 5 milionë lekë, në janar të vitit 2006. Këto lekë i ka pasur nga kursimet e tij dhe nga djali në emigracion, dhe i janë kthyer në fund të vitit 2006.
- b) Deklaratë e z. H. M, Janar 2006, ku ai deklaron se i ka dhënë Besnik M. Muçit në Janar 2006, 3000 euro borxh, nga puna e tij dhe e djalit në emigracion dhe i janë kthyer në vitin 2008 dhe nuk i ka më borxh;
- c) Deklaratë e B. dhe M. C, pa datë, ku deklarojnë se i kanë dhënë Besnik M. Muçit borxh 6.000 euro në muajin janar të vitit 2006. Kjo shumë është nga kursimet e punës në Angli prej vitit 1997 dhe është kthyer plotësisht në vitin 2008.

Komisioni ka hetuar në lidhje me çmimin e shitjes së këtij apartamenti në rrugën "\*\*\*\*", që duket në vlerë më të vogël sesa mendohet të ketë qenë çmimi mesatar real i zonës në vitin 2006. Komisioni ka hetuar në lidhje me shtetasen Z. D, pala shitëse e pasurisë së sipërcituar<sup>10</sup>, duke u nisur shkresë 16 bankave të cilat operojnë brenda vendit, duke kërkuar informacion mbi çdo veprimtari bankare dhe financiare që nga viti 2005 e deri më sot, si depozitë, kredi, overdraft, garanci, transferta etj., të kryera nga znj. Z. D.

<sup>9</sup>Shiko në dosje shkresën nr. \*\*\* prot., datë 05.01.2018, nisur ZVRPP-së Tiranë dhe përgjigjen e ardhur me nr. \*\*\* prot., datë 26.01.2018.

<sup>10</sup>Shiko në dosje shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.02.2018, nisur 16 bankave që operojnë brenda vendit.

Nga përgjigjet e ardhura nga bankat nuk rezulton ndonjë gjetje apo indice që mund të ngrejë dyshime në lidhje me çmimin e kontratës së shitblerjes së apartamentit me të dhënat e mësipërme.

- Është pyetur subjekti në lidhje<sup>11</sup> me huat e marra borxh nga babai, xhaxhai dhe kunati, se përse nuk janë hartuar në kohën e marrjes së këtyre borxheve, por pasi ato janë shlyer, si dhe për të paraqitur dokumentacion justifikues në lidhje me burimin e krijimit të shumave financiare të personave që i kanë dhënë atij borxh.

Subjekti shpjegon se ata janë personat më të afërt dhe u ka kërkuar deklaratë vetëm në momentin kur është kthyer borxhi.

- Në lidhje me të atin, z. M. M, ka paraqitur:
  - vërtetim nga Njësia Administrative \*\*\*, Bashkia Pogradec, nr. \*\*\* prot., datë 08.06.2018, sipas të cilit, që prej vitit 1991, babai ka përfituar të ardhura nga toka bujqësore 64.630 lekë/vit;
  - deklaratë dore të djalit të M. M, vëllait të subjektit, z. D. M, me të cilën vërteton faktin se në periudhën kohore 1996 - 2005 ka qëndruar dhe punuar si emigrant në Greqi, ku prej vitit 1998 ka qenë me leje të rregullt qëndrimi; si vendin ku ka punuar dhe të ardhurat që ka pasur.
  - disa dokumente të vëllait, të ruajtura pas kthimit nga Greqia, si dokumentin e datës 27.02.2001 për pajisjen me kodin fiskal ose lejen e punës, leje qëndrimi për vitet 2001 – 2002, si dhe një dokument të sigurimeve shoqërore.
- Në lidhje me shtetasin H. M, xhaxhai:
  - vërtetim nga Njësia Administrative \*\*\*, Bashkia Pogradec, nr. \*\*\* prot., datë 08.06.2018, sipas të cilit, që prej vitit 1991, babai ka përfituar të ardhura nga toka bujqësore 111.465 lekë/vit.
- Në lidhje me shtetasit B. e M. C:
  - deklaratë dore e dy personave të mësipërm, përkatësisht motra e subjektit dhe bashkëshorti i saj, me të cilin tregojnë kohën e qëndrimit në Angli, adresën, numrat e kartave të sigurimit, vendin e punës dhe të ardhurat mesatare mujore;
  - dokumentacion mbi gjendjen e llogarive bankare në “Credins Bank” më datë 31.12.2005, ku konfirmohet se motra e subjektit ka pasur në llogarinë e saj në këtë periudhë deri 8.600 euro (*konfirmuar edhe nga korrespondenca e Komisionit me bankat e nivelit të dytë*);
  - kopje të numrave të sigurimit, kopje të pasaportave ku pasqyrohen hyrje-daljet në Angli dhe Shqipëri, si dhe dokumente në gjuhën angleze të komunikimeve me bankat në Angli, ku janë derdhur të ardhurat e tyre nga punëdhënësi.

**Në lidhje me mundësinë financiare të subjektit në vitin 2006, për të blerë apartamentin e sipërcituar, është bërë analiza financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2006 e cila rezulton si më poshtë:**

### **Viti 2006**

---

<sup>11</sup>Shiko në dosje përgjigjet e pyetësorit më datë 19.04.2018, faqe 4.

Me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.01.2006, subjekti ka blerë një apartament në adresën Rr. “\*\*\*”, pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, me sip. 57.3 m<sup>2</sup>, me vlerë 1.900.000 lekë. Likuidimi i blerjes së apartamentit është bërë *cash* me mandatarkëtimi nr. 418, datë 16.01.2006, në emër të shitësit Z. D. Subjekti ka deklaruar si burim të ardhurash:

- 200.000 lekë nga kursimet e veta, të deklaruara si gjendje *cash* në vitin 2005;
- 3.000 euro borxh nga H. M;
- 6.000 euro borxh nga motra M. dhe B. C;
- 500.000 lekë borxh nga babai i tij.

**Të dhënat për këtë vit janë deklaruar si më poshtë:**

PËRSHKRIMI	Viti 2006
<b>PASURI</b>	<b>1.593.952</b>
Pakësuar likuiditetet <i>cash</i>	-200.000
Pakësuar gjendja e likuiditeteve në bankë	-106.048
Apartament banimi	1.900.000
<b>Detyrimet</b>	<b>1.113.327</b>
Borxh nga H. M 3.000 euro	371.109
Borxh nga motra M. dhe B.C 6.000 euro	742.218
Borxh nga babai i tij	500.000
Shlyerje borxhi babait	-500.000
<b>PASURI NETO</b>	<b>480.625</b>

<b>SHPENZIME</b>	<b>600.000</b>
Shpenzime jetese, sipas ILDKPI-së 2007	600.000
<b>Të ardhurat</b>	<b>874.800</b>
Paga subjekti	811.967
Pagë nga bashkëshortja	62.833
<b>DIFERENCA</b>	<b>-205.825</b>

Është pyetur subjekti në lidhje me këtë balancë financiare negative për vitin 2006 dhe në shpjegimet e tij dërguar Komisionit me shkresën me nr. \*\*\*prot., datë 25.07.2018, ai sqaron se: “Gjatë këtyre viteve, unë dhe familja ime kemi ndjekur një regjim të rreptë kursimi. Fëmijët kanë qenë të vegjël dhe kemi kryer vetëm shpenzime të nevojshme për jetesë (nuk kemi kryer udhëtime, pushime, kemi përdorur shërbimet publike për transport, nuk kemi udhëtuar asnjëherë jashtë Republikës së Shqipërisë, konfirmuar nga sistemi TIMS etj.).

*Po ashtu, më lejoni t’ju bëj me dije që gjatë kësaj periudhe, ne si familje jemi ndihmuar me shuma monetare dhe në forma të ndryshme (kemi marrë produktet bujqësore e blegtorale nga fshati etj.) nga prindërit e mi, vëllai im D. M, i cili ka qenë emigrant në Greqi, dhe familja e vjehrrit Z. M, i cili ka qenë i punësuar dhe vjehrra ka pasur një biznes të vogël tregtimi të rrobave për fëmijë.*

*Bashkëlidhur po ju dërgoj dy deklarata të shtetasve Z.M dhe D. M, që konfirmojnë faktet e mësipërme.”*

## ❖ Arsyetimi ligjor

Huatë e marra nga subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Muçi, nga personat e mësipërm janë deklaruar si në deklaratën e interesave private periodike/vjetore të vitit 2006, ashtu edhe në deklaratën “Vetting”.

Nga hetimi i kryer në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit, nuk rezulton ndonjë gjetje apo indice që mund të ngrejë dyshime mbi vendosjen e ndonjë çmimi fiktiv ndërmjet palëve kontraktuese.

Nuk rezultojnë dyshime në lidhje me aftësinë huadhënëse të shtetasve M. M, H. M, B. dhe M. C në shumat e sipërcituara.

Në lidhje me balancën financiare negative, duke marrë në konsideratë shpjegimet e dhëna nga subjekti për ndjekjen e një regjimi të rreptë financiar, si dhe ndihmat materiale të dhëna gjatë kësaj periudhe nga vjehri dhe vëllai i tij (*konfirmuar me deklaratimet përkatëse*), ajo rezulton të jetë e papërfillshme dhe nuk mund të arrihet në konkluzionin që kemi të bëjmë me shkelje ligjore që mund të çojnë deri në shkarkimin e subjektit nga detyra.

- 4. Shtesë objekti pallatit ekzistues, anësore, me sipërfaqe 27 m<sup>2</sup>, Rr. “\*\*\*”, pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë. Vlera: 650.000 lekë. Filluar ndërtimi në vitin 2008, përfunduar në vitin 2009. Deklaruar për legalizim në vitin 2008 dhe rideklaruar me deklaratën nr. \*\*\* prot., e dorëzuar tek ALUIZNI, më datë 29.09.2015.**

### **Burimi i krijimit:**

- Kursime nga të ardhurat prej punës së deklaruesit dhe bashkëshortes.

## **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të ndodhur në dosjen “Vetting” të depozituar nga subjekti në ILDKPKI dhe, nga kjo e fundit, në Komision, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka depozituar:

- dokumentin “Vetëdeklarim për legalizimin e shtesës”, shtojca A1, objekti: “Shtesë anësore pranë një pallati ekzistues”, me adresë Rr. “\*\*\*”, pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, kati i 2-të, Tiranë, me subjekt ndërtues: E. Z. M, investitor E. Z.M., konstruktor J. A, me sip. 27 m<sup>2</sup>, ku citohet se: “*Është realizuar një shtesë anësore, e cila i është bashkangjitur apartamentit \*\*\*, \*\*\*, Sh. -E, Kati -\*\*\*, shtesa është integruar me banesën ekzistuese*”. Vetëdeklarimi është firmosur nga E. M dhe është pa datë plotësimi;
- dokumenti “Deklaratë për përfshirjen në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje ose shtesë në ndërtim me leje”, personi deklarues është B. M. M dhe P. A. K, protokolluar te Drejtoria e ALUIZNI-t “Tirana 2”, me nr. \*\*\* prot., datë 29.09.2015, që kërkojnë të legalizojnë shtesë anësore në ndërtim me leje”, me adresë: Rr. “\*\*\*”. pall. \*\*\*, sh. \*\*\*, kati i \*\*\*, Tiranë. Subjekti deklaron në formular se ndërtimi është ngritur në 2006 - 2007. Në lidhje me pronësinë e truallit ku është ngritur shtesa deklaron se: “*Nuk kam dijeni se pronë e kujt është*”.
- Në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.01.2018, “Kthim përgjigje” të Drejtorisë së ALUIZNI-t “Tirana 2”, sqarohet se: “*Pranë drejtorisë sonë administrohet praktika e legalizimit me nr. \*\*\* prot., datë 29.09.2015, ku z. Besnik Muçi, së bashku me z. P. K, kanë paraqitur “Kërkesën për legalizimin e ndërtimit informal” të llojit “shtesë anësore”, me adresë: Rr. ‘\*\*\*, pall. \*\*\*, dhe kjo praktikë është në fazën fillestare të procesit të legalizimit dhe e*

*papërditësuar me dokumentacion nga subjektet*". Është dërguar edhe praktika përkatëse bashkëlidhur.

- Me shkresën e Komisionit nr. \*\*\* prot., datë 15.02.2018, i është kërkuar Drejtorisë së ALUIZNI-t "Tirana 2" informacion nëse shtesa anësore për të cilin në ILDKPKI janë depozituar dy vetëdeklarime është e njëjta apo kemi të bëjmë me dy ndërtime të ndryshme.

Me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 21.02.2018, Drejtoria e ALUIZNI-t "Tirana 2" konfirmon se shtetasit Besnik Muçi dhe P. K kanë deklaruar me nr. \*\*\* prot., datë 29.09.2015, për legalizimin e ndërtimit informal me adresë Rr. "\*\*\*\*", pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, kati i \*\*\*, Tiranë. Gjithashtu, në lidhje me vetëdeklarimin e shtetasës E. Z. M, informohet se nuk rezulton praktikë legalizimi, referuar bazës dixhitale të informacionit që disponon Drejtoria e Përgjithshme e ALUIZNI-t, verifikimit të dosjeve fizike në arkiv dhe regjistrin të të dhënave.

Në lidhje me faktin se në dosje ndodhen dy kërkesa për aplikim (*formular tip i ALUIZNI-t*), një në emër të bashkëshortes E. Z. M dhe një në emër të subjektit dhe përgjigjja e ardhur nga ALUIZNI nuk e konfirmonte kërkesën e parë për legalizim në emër të bashkëshortes, u pyet subjekti për të dhënë sqarim në lidhje me këtë fakt, si dhe për faktin se cila është periudha e saktë e ndërtimit të shtesës dhe e deklarimit të saj pranë zyrës së ALUIZNI-t, cila është arsyeja se një herë shtesa është deklaruar e ndërtuar në vitin 2006 - 2007, kurse në deklaratat periodike të pasurisë për vitet 2008, 2009 dhe në deklaratën "Vetting" shtesa është deklaruar e ndërtuar në vitet 2008 - 2009.

Në përgjigjen e dhënë pyetësorit<sup>12</sup>, subjekti Besnik Muçi deklaroi se: *"Kjo shtesë është ndërtuar gjatë viteve 2008 - 2009. Ky ndërtim është vetëdeklaruar pranë ALUIZNI-t për legalizim në vitin 2008, në emër të bashkëshortes E. M. Duke qenë se legalizimi i shtesës nuk po mbyllet, gjatë muajit shtator 2015, unë jam interesuar vetë te zyrat e ALUIZNI-t dhe më kanë informuar që dosja jonë, me vetëdeklaruese bashkëshorten time E. M, pavarësisht se ishte e regjistruar në sistemin elektronik të Zyrës, nuk ndodhej fizikisht, kishte humbur. Ndodhur në këto kushte, duke qenë se ishin datat e fundit të vetëdeklarimeve, pasi u konsultova dhe me specialistë të zyrës së ALUIZNI-t dhe me sugjerimin e tyre, kam bërë vetëdeklarimin e datës 29.09.2015 në emrin tim. Vendosija e emrit të shtetasit P. K në formularin e vetëdeklarimit është sugjerim i specialistit të zyrës së ALUIZNI-t se duhet të vendosen emrat e pronarëve të shtesave. Shtesa është dy kate dhe ky shtetas është pronar i shtesës në katin e parë."*

Në lidhje me pyetjen pse është deklaruar që ndërtimi është bërë në vitet 2006 - 2007 dhe herën tjetër në vitet 2008 - 2009, subjekti sqaroi se këtë deklarim e ka bërë nga shpejtësia dhe pamundësia për të parë dokumentet në shtëpi. Formulari është plotësuar në sportelin e ALUIZNI-t.

Në lidhje me vlerën e shpenzimeve të kryera, subjekti deklaroi në pyetësor se ka marrë ustallarë dajën e tij apo persona, që i ka njohur nëpërmjet miqve të tij, të cilët i ka paguar me para në dorë dhe, për këtë arsye, nuk disponon dokumentacion justifikues në lidhje me kostot e ndërtimit të shtesës. Bashkangjitur përgjigjeve të pyetësorit, subjekti ka depozituar deklaratë me shkrim dore të ustallarëve në lidhje me pagesat për punën e kryer, konkretisht:

- deklaratë e z. J. (H.) B. G, datë 14.04.2018, që konfirmon se gjatë viteve 2008 - 2009 ka bërë punime të ndryshme ndërtimi, si armaturë, punim hekuri, muraturë, punime

<sup>12</sup>Shiko për më tepër në dosje të KPK përgjigjet e pyetësorit të dhëna nga subjekti datë 19.04.2018.

Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 15.02.2018, drejtuar Drejtorisë së ALUIZNI-t "Tirana 2", me përgjigjen nr. \*\*\*prot., datë 02.03.2018.

- çatie etj., në objektin shtesë pallati, kati i dytë, në pronësi të z. Besnik Muçi, në rrugën “\*\*\*”, Tiranë, dhe është paguar 380.000 lekë për karabinanë dhe 80.000 lekë për çatinë;
- deklaratë, datë 14.04.2018, e z. F. G N, që konfirmon kryerjen e punimeve për dyer dhe dritare duralumini në një shtesë anësore pallati, kati i dytë, në Rr. “\*\*\*”. Vlera e punimeve ka qenë 90.000 lekë, të cilat janë paguar në dorë nga porositësi Besnik Muçi;
  - deklaratë, datë 15.04.2018, nga z. A. Sh, që konfirmon bërjen e suvatimeve jashtë dhe brenda te shtesa e pallatit ku jetonte nipi në Tiranë, në vitin 2009, dhe është paguar 20.000 lekë.
- Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.06.2018, iu kërkua ILDKPKI-së konfirmimi i vërtetësisë së dokumentit “Vetëdeklarim për legalizimin e shtesës”, Shtojca A1, objekti “Shtesë anësore pranë një pallati ekzistues”, me adresë Rr. “\*\*\*”, pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, kati i \*\*\*, Tiranë, me subjekt ndërtues E. Z M.

Me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 21.06.2018, ILDKPKI-ja na bën me dije se: *“Subjekti Besnik M. Muçi, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka dorëzuar më datë 26.01.2017 Deklaratën e Pasurisë “Shtojca 2”, së bashku me dokumentacionin përkatës. Pjesë e dokumentacionit të dorëzuar në zbatim të ligjit të sipërcituar ka qenë edhe vetëdeklarimi i bërë nga bashkëshortja E. M, për legalizimin e shtesës anësore, me adresë Rr. “\*\*\*”, Tiranë, i cili në fund të fletës së majtë nuk ka të shënuar datë. Në ILDKPKI është administruar procesverbal, datë 17.02.2016, mbi dorëzimin e dokumenteve, mbajtur nga inspektori i ILDKPKI-së, E. D, dhe subjektit deklarues Besnik Muçi, ku në numrin. 4 rendor të tij citohet: “Vetëdeklarim për legalizim datë 29.12.2006 (1 faqe)”. Referuar vetëdeklarimit, ai është bërë për legalizimin e shtesës anësore me adresë Rr. “\*\*\*”, Tiranë dhe mban datën 29.12.2006. Ky formular vetëdeklarimi nuk është i njëjtë me formularin e dorëzuar nga subjekti së bashku me Deklaratën e Pasurisë “Shtojca 2”.*

*Bashkëlidhur ju vëmë në dispozicion:*

- *vetëdeklarimin e bërë nga E. M, që mban datën 29.12.2006, administruar në ILDKPKI sipas procesverbalit të mbajtur me datë 17.02.2016;*
- *vetëdeklarimin e bërë nga E. M, i cili është pa datë dhe është administruar në ILDKPKI në datën 26.01.2017, së bashku me inventarin e dokumentacionit justifikues/shoqërues të Deklaratës së Pasurisë së subjektit, Besnik Muçi.”*

Konstatohet se dokumenti “Vetëdeklarim për legalizimin e shtesës” Shtojca A1, i datës 29.12.2006, i dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI më datë 17.02.2016, ka të shënuar apartamentin nr. \*\*\*, pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, dhe atësia e E. M është shënuar \*\*\*, në një kohë kur në dokumentin “Vetëdeklarim për legalizimin e shtesës”, Shtojca A1, objekti “Shtesë anësore pranë një pallati ekzistues”, me adresë Rr. “\*\*\*”, pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, kati i \*\*\*, ap. \*\*\*, i administruar në ILDKPKI, në datën 26.01.2017, së bashku me inventarin e dokumentacionit justifikues/shoqërues të deklaratës së pasurisë së subjektit, z. Besnik Muçi, apartamenti është me nr. \*\*\* dhe atësia e E. M është \*\*\*.

Është pyetur përsëri subjekti nëse formulari i vetëdeklarimit të shtesës anësore, i depozituar nga subjekti në ILDKPKI me procesverbalin e datës 17.02.2016, është plotësuar nga bashkëshortja dhe nëse bëhet fjalë për të njëjtën shtesë anësore të integruar me apartamentin ekzistues, të ndodhur në Rr. “\*\*\*”, pall. \*\*\*, ap. \*\*\*, shk. \*\*\*, kati i \*\*\*, në pronësi të subjektit, shtesë për të cilën janë depozituar dy vetëdeklarime.

Në përgjigjen e tij, subjekti sqaron se: *“Ky vetëdeklarim është plotësuar nga ne dhe është firmosur nga bashkëshortja, si bashkëpronare, por konstatohet një lapsus në datën e vendosur në fund të vetëdeklarimit, që është 29.12.2006. Duke qenë se ky ndërtim është bërë në vitet 2008 - 2009, rrjedhimisht dhe ky vetëdeklarim është bërë në vitin 2008. Kjo konfirmohet nga*

*deklaratat periodike të pasurive të viteve 2008 - 2009, si dhe në deklaratën 'Vetting'. Për të konfirmuar kohën e ndërtimit, kam kërkuar te zyra e ALUIZNI-t hartat dixhitale të zonës të Rr. '\*\*\*, pall. \*\*\*, për datën 01.12.2007 dhe për datën 01.07.2008.*

*Bëhet fjalë për të njëjtën shtesë anësore të deklaruar nga ana ime në deklaratat periodike të pasurive, të viteve 2008 dhe 2009, si dhe në deklaratën 'Vetting' të vitit 2017".*

Është pyetur përsëri subjekti për të konfirmuar kohën e saktë të depozitimit të formularit të vetëdeklarimit për shtesën anësore, të plotësuar dhe firmosur nga bashkëshortja.

Në përgjigje të pyetjes së mësipërme, subjekti deklaroi se formulari i vetëdeklarimit për shtesën anësore në emrin e bashkëshortes është dorëzuar rreth muajit qershor 2008, në zyrat e Njesisë Bashkiake Nr. 2.

- Në lidhje me saktësimin e kohës kur janë pranuar formularët e vetëdeklarimeve nga zyrat përkatëse në njësitë e qeverisjes vendore dhe zyrat e ALUIZNI-t, është kryer korrespondencë me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t dhe nga përgjigja me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 02.07.2018, rezultoi se afatet për kryerjen e vetëdeklarimeve, si dhe institucionet e ngarkuara për administrimin e tyre, janë si më poshtë:
- pranë njësisë së qeverisjes vendore, në periudhën dhjetor 2004 - mars 2005, sipas nenit 7 të ligjit nr. 9304, datë 28.10.2004, "Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale";
- pranë zyrës së urbanistikës së njësisë së qeverisjes vendore, në periudhën qershor 2006 – nëntor 2006, sipas nenit 7 të ligjit nr. 9304, datë 28.10.2004, "Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale";
- pranë ALUIZNI-t, në periudhën maj 2013 - korrik 2013, sipas nenit 45/1, pika 2, të ligjit nr. 141/2013, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin dhe urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar;
- pranë ALUIZNI-t, në periudhën nëntor 2014 - janar 2015, sipas nenit 45/1 të ligjit nr. 50/2014, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, "Për legalizimin dhe urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" të ndryshuar.

Nga përgjigja e ALUIZNI-t konstatohet se për periudhën kohore nëntor 2006 - maj 2013 nuk janë pranuar vetëdeklarime të ndërtimeve pa leje, as nga zyrat e njësisë së qeverisjes vendore, as nga zyrat e ALUIZNI-t.

Subjekti, më datë 05.07.2018 ka dërguar në rrugë elektronike në Komision përgjigjen e Drejtorisë së ALUIZNI-t "Tirana 2", me nr. \*\*\* prot., datë 05.07.2018, ku konfirmohet ekzistenca e deklaratës për përfshirje në procedurat e legalizimit, nr. \*\*\* prot., datë 29.09.2015, e shtetasit B. M. M dhe P. A. K, për legalizimin e shtesës anësore në objektin ekzistues, si dhe vënia në dispozicion të subjektit ortofoto e vitit 2007, ortofoto e vitit 2015 dhe ortofoto në format dixhital, CD.

Subjektit të rivlerësimit, më datë 18.07.2018, iu kalua barra e provës për të dhënë argumente dhe prova në lidhje me konstatimet e bëra nga ana e Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa më poshtë:

- "Duket se ka të dhëna kontradiktore dhe pasaktësi dhe dyshime për deklarim të rremë në lidhje me vitin e ndërtimit të shtesës anësore nga ana juaj, sepse në lidhje me kohën e ndërtimit informal 'shtesë anësore' në dy formularë vetëdeklarimi, konkretisht dokumenti 'Vetëdeklarim për legalizimin e shtesës', shtojca A1, që bën fjalë për objektin: 'Shtesë anësore pranë një pallati ekzistues, Rr. "\*\*\*, pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*,

*e integruar me banesën ekzistuese, i firmosur nga bashkëshortja e subjektit, mban datën 29.12.2006 (i depozituar nga subjekti në ILDKPKI me procesverbalin e datës 17.02.2006) dhe formulari i vetëdeklarimit i plotësuar dhe i depozituar nga vetë subjekti me nr. \*\*\* prot., në datën 29.09.2015, në të cilin është specifikuar se ndërtimi është bërë në vitet 2006 - 2007, shtesa anësore deklarohet si e ndërtuar një herë në vitin 2006 dhe një herë në vitet 2006 - 2007 (në pyetësor keni deklaruar se kemi të bëjmë me plotësim gabim të vitit të ndërtimit).*

*Nga ana tjetër, po e njëjta shtesë anësore, është deklaruar e ndërtuar nga ana juaj në vitet 2008 - 2009, si dhe e deklaruar në formularët përkatës të deklarimit të pasurisë në vitet 2008 - 2009 dhe në deklaratën "Vetting" (në pyetësor keni deklaruar se keni dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në qershor 2008, në zyrat e Njësisë Bashkiake nr. \*\*\*).*

- *Rezulton se keni deklaruar vlerën e shpenzuar për shtesën anësore të katit, por nuk keni paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për shpenzimet e kryera për këtë ndërtim informal.*
- *Në lidhje me shtesën anësore të deklaruar të ndërtuar nga subjekti në vitet 2008 - 2009, si dhe të deklaruar në formularët përkatës të deklarimit të pasurisë në vitet 2008 - 2009 dhe në deklaratën "Vetting", duke marrë në konsideratë edhe faktin se subjekti në formularin e vetëdeklarimit deklaroi se nuk e di i kujt është trualli, bazuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, neni 199/a, në kohën e ndërtimit të shtesës anësore, duket se keni konsumuar veprën penale të ndërtimit të paligjshëm, citojmë: "Ndërtimi i kryer pa leje, në shkelje të rëndë të lejes ose në kushtet e një lejeje të shfuqizuar në tokën në pronësi të vet, dënohet me burgim deri në një vit. Po kjo veprë, e kryer në tokën publike ose shtetërore, apo në tokën e tjetrit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet", duke cenuar rëndë figurën e prokurorit."*

Subjekti, në shpjegimet e veta të protokolluara në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 25.07.2018, sqaron si më poshtë:

*"Në lidhje me shtesë anësore, objekti pallat ekzistues, sipërfaqe 27 m<sup>2</sup>, rruga*

*"\*\*\*", pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, vlera 650.000 lekë, ndërtuar në vitet 2008 (300.000 lekë) dhe 2009 (350.000 lekë), deklaruar për legalizim në vitin 2008 dhe rideklaruar në vitin 2015, hetimi administrativ ka konstatuar se:*

- *ka dyshime për kohën e ndërtimit të shtesës;*
- *kam deklaruar vlerën e shpenzimeve, por nuk kam paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për shpenzimet e kryera*
- *duke qenë se ndërtimi është kryer gjatë viteve 2008 - 2009 jo në truallin tim, kam konsumuar veprën penale të "Ndërtimit të paligjshëm", parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, duke cenuar rëndë figurën e Prokurorit.*

*Përgjigjja: Lidhur me konstatimin e parë, u qëndroj të gjitha shpjegimeve që ju kam paraqitur gjatë pyetësorëve. Gjithashtu, ju bëj me dije faktin se ky ndërtim është kryer gjatë muajve të parë të vitit 2008, ku ka përfunduar ndërtimi karabina (kolonat, soleta e katit dhe 2 muret rrethuese, pasi dy të tjerat janë të pallateve ekzistues, dhe mbulesa). Për këtë ndërtim, në deklaratën vjetore të pasurisë së vitit 2008 kam deklaruar 300.000 lekë shpenzime. Kryerja e punimeve të tjera të kësaj shtese ka vazhduar dhe gjatë vitit 2009 (suvatimet, instalime elektrike, shtrim pllakash, lyerje, vendosje dyer e dritare, mobilim etj.) kur dhe është lidhur me apartamentin ekzistues, mobiluar dhe është bërë funksionale.*

*Kohën e kryerjes së këtyre ndërtimeve, shpenzimet e kryera dhe burimin e tyre, e kam dhënë në deklaratat vjetore të pasurisë së viteve 2008 dhe 2009.*



*Bashkëlidhur shpjegimeve, po ju paraqes edhe një deklaratë dore të shtetasit Petrit Kërçiku, sipas së cilës ndërtimin e shtesës së katit të parë e ka kryer në muajt e parë të vitit 2008.*

*Lidhur me konstatimin e dytë, unë u qëndroj shpjegimeve që kam dhënë në përgjigjen e pyetjes së dytë të pyetësorit nr. 2. Më lejoni të shtoj se legjislacioni i kohës kur është bërë shtesa dhe i sotmi nuk parashikojnë obligime as edhe për ruajtjen e dokumenteve tatimore për një periudhë kohë më të gjatë se 5 vjet.*

*Lidhur me konstatimin e tretë, vlerësoj se përfundimi i arritur nga ana juaj për faktin se “...duke qenë se ndërtimi është kryer gjatë viteve 2008 - 2009 jo në truallin tuaj, kam konsumuar veprën penale të “Ndërtimit të paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, duke cenuar rëndë figurën e Prokurorit..” nuk qëndron dhe nuk është i mbështetur në dokumentet e marra në kuadrin e hetimit administrativ, përfshi edhe përgjigjet dhe dokumentet e dërguara nga unë.*

**Së pari:** Unë kam ndërtuar shtesën anësore pa leje, por duhet theksuar se:

- është filluar në janar 2008 dhe pjesa ndërtesa karabina (kolona, mure rrethuese, soletë) ka përfunduar brenda muajit qershor 2008;
- që është bërë për nevoja ekstremisht të ngutshme banimi familjare;
- që është bërë mbi ndërtimin e pronarit të apartamentit të katit të parë, pra nuk kam zënë truall;
- që ndërtimi i shtesës së katit të parë vinte në rrezik sigurinë e familjes sime dhe integritetin e banesës, pasi soleta e tij ishte pranë dritares; si dhe
- që ky ndërtim nuk ka zënë asnjë hapësirë publike, por vetëm pjesën pas dritares së banesës sime dhe hapësirën e planifikuar për dritë dhe ajrim të saj (rreth 2.8 m gjerësi dhe rreth 9 m gjatësi, sipas shtrirjes së murit të apartamentit tim).

**Së dyti:** Provat e administruara gjatë këtij hetimi tregojnë faktin që në muajin qershor 2008 unë kisha përfunduar ndërtimin e objektit në strukturën e tij dhe në vitin 2009 kam kryer vetëm punime të brendshme. Konkretisht:

- Deklarimet e shtetasve J. (H.) G, F. N dhe A.Sh, të cilat konfirmojnë faktin e punimeve të ndërtimit që kanë kryer dhe kohën e kryerjes.
- Fakti që unë në deklarinimin e pasurisë së vitit 2008 kam deklaruar fillimin e shtesës gjatë atij viti dhe shpenzimet përkatëse me të cilat ka përfunduar ndërtimi i karabinasë (kolona, mure rrethuese, soletë).
- Deklarimet e shtetasit P. K, që ai e ka ndërtuar shtesën e tij në muajt e parë të vitit 2008.

*Ligji nr. 10023, datë 27.11.2008, ‘Për disa shtesa e ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë’, i cili ka shtuar në Kodin Penal nenin 199/a, ku parashikohet si vepër penale ndërtimi i paligjshëm, është dekretuar më 29.12.2008 nga Presidenti i Republikës dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, në vitin 2009.*

*Pra, ndërtimi i shtesës anësore është kryer para se të hynte në fuqi ligji që e parashikonte si vepër penale ndërtimin pa leje.*

*Po ashtu, sipas të gjitha parashikimeve të legjislacionit të ndërtimit të kohës dhe atij aktual (ligji nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim”, i ndryshuar, ligji nr. 107 i vitit 2004 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM-ja nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, neni 6) nuk kërkohet pajisja me leje ndërtimi për kategorinë e punimeve që unë kam kryer gjatë vitit 2009 në shtesën e mësipërme (suvatime, instalime elektrike, shtrim pllakash, lysterje, vendosje dyer e dritare etj.).*

*Në kushtet kur ndërtimi i shtesës anësore është kryer para se të hynte në fuqi ligji që e parashikonte si vepër penale ndërtimin pa leje, si dhe kur për punimet që unë kam kryer në vitin 2009, punime të brendshme (suvatime, instalime elektrike, shtrim pllakash, lysterje, vendosje dyer e dritare etj.), nuk është kërkuar pajisja me leje ndërtimi, nuk ka dyshime se mund të kem konsumuar vepër penale të “Ndërtimit pa leje” dhe cenuar kështu figurën e prokurorit.*

*Bashkëlidhur shpjegimeve, po ju paraqes deklaratën personale të shtetasit Petrit Kërçiku.”*

Pavarësisht të dhënave kontradiktore dhe pasaktësive në lidhje me deklarin e vitit të ndërtimit të shtesës anësore në pallatin ekzistues, i ndodhur në Rr. “\*\*\*”, pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, kati i \*\*\*, në formularët e vetëdeklarimit të depozituar në zyrën e ALUIZNI-t (*deklaruar si e ndërtuar në vitet 2006 - 2007*), kjo shtesë anësore rezulton e deklaruar në deklaratat e interesave private periodike/vjetore, si e ndërtuar në vitet 2008 (*300.000 lekë*) dhe 2009 (*350.000 lekë*).

Në deklaratën “Vetting”, fillimi i ndërtimit të shtesës anësore është deklaruar në vitin 2008 dhe përfundimi i ndërtimit në vitin 2009 dhe deklaruar për legalizim në vitin 2008. Pra, ka një përputhje të deklarin të periudhës së ndërtimit të shtesës në ILDKPKI midis deklarimeve të pasurisë në vitet 2008, 2009 dhe deklaratës “Vetting”. Ky fakt përforcohet më shumë me deklarimet e dhëna nga punëtorët që kanë punuar për ndërtimin e shtesës anësore, konkretisht: a) Deklaratë e z. J. (H.) B. G, datë 14.04.2018; b) Deklaratë, datë 14.04.2018, e z. F. G. N; c) Deklaratë z. A. Sh, datë 15.04.2018; ç) Deklaratë e z. A. K, që deklaroi se ka ndërtuar një shtesë pallati në muajt e parë të vitit 2008 në Rr. “\*\*\*”, pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*.

Nga subjekti i rivlerësimit janë vënë në dispozicion të Komisionit (*me nr. \*\*\* prot., datë 06.07.2018*), shkresa kthim përgjigje e Drejtorisë së ALUIZNI-t “Tirana 2”, nr. \*\*\* prot., datë 05.07.2018, që përmban ortofoto të vitit 2007 dhe 2015 dhe ortofoto në format dixhital, nga të cilat duket qartësisht se në vitin 2007 nuk ka pasur ndërtim shtesë anësore ngjitur me pallatin ekzistues (por vetëm një ndërtim të shkëputur nga dy faqet anësore të dy pallateve, kurse në ortofoton e vitit 2015 rezulton në mënyrë të qartë se kemi të bëjmë me një shtesë anësore të lidhur me pallatin ekzistues. Gjithashtu, nga subjekti në seancë dëgjimore u vunë në dispozicion të Komisionit me cilësinë e provës dhe një dokument i titulluar “Ndërtim shtesë anësore”, i përgatitur nga inxhinier J. A, me shënimin “Tiranë 2008”, ku pasqyrohen planvendosja, planimetria, plani i strukturave dhe një preventiv, që mban datën 10.02.2008, si edhe fotografi të shtesës anësore.

Nga përmbajtja e deklaratave të pasurisë në lidhje me shtesën anësore, si ato të viteve 2008 dhe 2009, dhe nga ajo “Vetting”, deklarimet e subjektit, të punëtorëve, të poseduesit të shtesës në katin e parë, si dhe provat e paraqitura nga subjekti në seancë dëgjimore, krijohet bindja se shtesa anësore në katin e dytë, është ndërtuar në themele, strukturë dhe mbulesë në vitin 2008, ndërsa punimet e tjera, si suvatime, instalime elektrike, shtrim pllakash, lysterje, vendosje dyer e dritare, janë kryer në vitin 2009. Duke qenë se shtesa e ndërtuar nga subjekti është në katin e dytë, pra jo direkt në tokë, nuk kemi të bëjmë me shpërdorim apo pushtim të tokës nga ana e tij e për rrjedhojë nuk është konsumuar vepër penale sipas legjislacionit të kohës.

#### ❖ **Arsyetimi ligjor**

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në zyrat e ALUIZNI-t një shtesë anësore në pallat ekzistues (*kati i dytë*), të ndërtuar në vitin 2008, të deklaruar për legalizim në vitin 2008 dhe përsëritur në vitin 2015, për të cilën akoma nuk është pajisur me leje legalizimi.

Shtesa anësore në emër të subjektit është ndërtuar në katin e dytë mbi katin përdhes, i cili po ashtu është vetdeklaruar për legalizim në zyrat e ALUIZNI-t nga shtetasi P. K, duke mos pasur lidhje të drejtpërdrejtë, të trupëzuar mbi tokën.

Në nenin 75, kreu VII “Ndërtimet e kundërligjshme dhe zënia arbitrare e truallit” ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998, “Për urbanistikën”, parashikohet se: “Zënia arbitrare e truallit për çdo lloj ndërtimi, përveç dënimit me gjobë, shoqërohet edhe me detyrimin e prishjes së menjëhershme të objektit dhe kthimin e truallit në gjendjen e mëparshme me shpenzimet e kundërvajtësit”.

Në Kodin Penal, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, në seksionin XI, janë parashikuar veprat penale që çënojnë regjimin juridik të tokës si “shpërdorimi i tokës” dhe “pushtimi i tokës”, por akoma nuk ka një parashikim të ndërtimit të paligjshëm si vepër penale.

Ligjvënësi, duke marrë shkas nga numri shumë i madh i ndërtimeve të paligjshme, të ndërtuara pa leje ndërtimi dhe në mënyrë të pakontrolluar nga shteti, situatë që po çënonte në mënyrë të pariparueshme zhvillimin e territorit, e konsideroi domosdoshmëri ndërhyrjen në Kodin Penal, duke e parashikuar ndërtimin pa leje për herë të parë si figurës të veprës penale më vete. Konkretisht, në ligjin nr. 10023, datë 27.11.2008 (*hyrë në fuqi në janar 2009*), në nenin 199/a, parashikohet se: “Ndërtimi i kryer pa leje, në shkelje të rëndë të lejes ose në kushtet e një lejeje të shfuqizuar në tokën në pronësi të vet, dënohet me burgim deri në një vit.

*Po kjo vepër, e kryer në tokën publike ose shtetërore apo në tokën e tjetrit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet”.*

Marrë shkas nga ky zhvillim kaotik i ndërtimeve informale, të cilat ishin në një numër shumë të madh dhe të shtrira pothuajse në të gjithë territorin e vendit, ligjvënësi, me qëllim ndalimin e këtij fenomeni, si edhe integrimin e këtyre ndërtimeve informale, për aq sa ishte e lejuar, në zhvillimin urban të vendit, por edhe në qarkullimin civil, miratoi një paketë të plotë ligjore, konkretisht ligjin nr. 9304, datë 28.10.2004, “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale” dhe ligjin nr. 9209, datë 23.03.2004, “Për legalizimin e shtesave në ndërtime”, të cilat më vonë u kombinuan në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”.

Sa më sipër, ndërtimi pa leje i shtesës anësore nga subjekti nuk është i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë e të trupëzuar me tokën, por është ngritur mbi katin përdhes; për të nuk është lëshuar akoma leje legalizimi nga zyra e ALUIZNI-t; është parashikuar si kundërvajtje administrative në bazë të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998, “Për urbanistikën” dhe nuk përbën vepër penale në bazë të legjislacionit në fuqi në kohën e ndërtimit.

Subjekti i rivlerësimit në lidhje me këtë ndërtim pa leje:

- a) Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- b) Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- c) Nuk ka kryer deklaram të remë;
- d) Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit;
- e) Nuk ka konsumuar vepër penale në bazë të legjislacionit të kohës,

e për rrjedhojë nuk mund të konkludojmë për shkelje të ligjit nga ana e subjektit në atë masë sa të përbëjë shkak për shkarkimin e tij nga detyra.

## **5. Riparim dhe mobilie shtëpie, gjatë viteve 2010 dhe 2011, në shumën 380.000 lekë.**

### **Burimi i krijimit:**

- Kursime nga të ardhurat prej punës së subjektit dhe bashkëshortes.

## Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

Nga verifikimi i deklaratave të interesave private periodike/vjetore rezulton se subjekti ka deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2010 shpenzime mobilimi në shumën 277.000 lekë dhe në deklaratën e vitit 2011 shpenzime mobilimi në shumën 105.000 lekë

Të dhënat e mësipërme përputhen me ato të deklaruara nga subjekti në deklaratën “Vetting”.

Analiza financiare e viteve 2010 dhe 2011, si më poshtë:

		Viti 2010	Viti 2011
	<b>ANALIZA FINANCIARE</b>		
1	Të ardhurat	2.394.397	<b>2.011.500</b>
	Paga e subjektit	1.967.737	1.564.230
	Paga e bashkëshortes	426.660	447.270
2	Pasuritë	619.454	<b>1 253 101</b>
	Shtuar gjendja e likuiditeteve	619.454	1,253,101
	Tokë 300 m <sup>2</sup> në ***, Tiranë		0
	Shtesë pallati anësore, sip. 27 m <sup>2</sup> , Tiranë		
	Automjet tip “Benz”, targë ***		
3	Detyrimet		0
4	Shpenzimet	<b>949.875</b>	<b>818.406</b>
	Riparim dhe mobilim shtëpie	277.000	105.000
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI, 2008	600.000	600.000
	Shpenzime udhëtimi jashtë shtetit (TIMS)	72.875	113.406
	<b>Diferenca</b>	<b>825.067</b>	<b>-60.007</b>

Rezulton se për vitin 2010 subjekti ka pasur të ardhura financiare të mjaftueshme për të përballuar kryerjen e investimeve në riparim dhe blerje mobilimesh. Për vitin 2011, pavarësisht se rezulton me një balancë financiare negative prej – 60.007 lekësh, kjo rezulton të jetë e papërfillshme në vlerë, krahasuar me intensitetin e të ardhurave, si dhe shpenzimeve të kryera në këtë vit e, për rrjedhojë, nuk mund të arrihet në konkluzionin që kemi të bëjmë me shkelje ligjore që mund të çojnë deri në shkarkimin e subjektit nga detyra.

- 6. Tokë bujqësore 300 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, faq. \*\*\*, zona kadastrale nr. 3976, në \*\*\*, Tiranë. Blerë me kontratë shitjeje, pasuri e paluajtshme nr. \*\*\* rep. dhe \*\*\* kol., datë 09.01.2012. Vlera: 111.600 lekë.**

### **Burimi i krijimit:**

- Kursime nga të ardhurat prej punës së deklaruesit dhe bashkëshortes.

## Hetimi i kryer nga Komisioni

Nga Komisioni është kryer hetim i thelluar në lidhje me vërtetësinë e çmimit të shitjes së kësaj pasurie të paluajtshme.

Nga korrespondenca e kryer me ZVRPP-në Tiranë<sup>13</sup> në lidhje me këtë pasuri, konfirmohet pasuria e llojit “Arë” me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>, regjistruar me nr. \*\*\*, ZK \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, në pronësi të Besnik Muçit në bazë të kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 09.01.2012, vlera 111.600 lekë + praktika.

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 04.06.2018, ZVRPP-ja Tiranë konfirmon se çmimi i referencës për pasurinë e llojit “arë”, për ZK \*\*\*, \*\*\*, në vitin 2012, sipas VKM-së së vitit 2011, pasi me anën e kësaj VKM-je përcaktoheshin dhe çmimet e referencës për vitin 2012, është në vlerën 372 l/m<sup>2</sup>.

Komisioni ka kryer hetime në lidhje me pasurinë në pronësi të shtetasit T. L, pala shitëse e kësaj pasurie subjektivit<sup>14</sup>, duke dërguar shkresë ZVRPP-së Tiranë në lidhje me regjistrime dhe transaksione pasurie të paluajtshme të kryera nga shtetasi T. L, në zonën kadastrale \*\*\*, Tiranë, si dhe çdo praktikë penale dhe gjyqësore në lidhje me këto veprime juridike.

Gjithashtu, Komisioni ka kryer korrespondencë me 16 institucione bankare<sup>15</sup> në lidhje me llogari, depozita, transaksione, prej vitit 2005 e deri më sot për shtetasin T. L.

#### ❖ Konkluzion

*Nga verifikimet e kryera nga Komisioni nuk rezulton të ketë indice apo prova që të ngrihen dyshime në lidhje me vërtetësinë e çmimit të vendosur nga palët në kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 09.01.2012, çmimi 111.600 lekë (çmimi i njëjtë më atë të përcaktuar me VKM-në për l/m<sup>2</sup>), për pasurinë e llojit “arë” me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, zona kadastrale nr. \*\*\*, në \*\*\*, Tiranë.*

#### **7. Tokë bujqësore, me sipërfaqe 2000 m<sup>2</sup>, pasuria me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, zona kadastrale nr. \*\*\*, fshati S\*\*\*, Pogradec. Vlera: 850.000 lekë.**

Për këtë pasuri është lidhur kontrata premtim shitjeje me pronarët, nr. \*\*\* rep. dhe nr. \*\*\* kol., datë 29.11.2014. Është kryer pagesa dhe është marrë në dorëzim prona. Nuk është kryer ende kalimi në regjistrin e ZRPP-së Pogradec për shkak të procedurave të trashëgimisë, të papërfunduara nga pronarët.

#### **Burimi i krijimit:**

- Kursime nga të ardhurat prej punës së deklaruesit dhe bashkëshortes.

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Nga korrespondenca e kryer me ZVRPP-në Pogradec<sup>16</sup>, ku është kërkuar praktika e plotë e regjistrimit dhe çdo transaksion për pasurinë e paluajtshme me të dhënat e sipërcituara,

<sup>13</sup>Shiko në dosje shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 05.01.2018, nr. \*\*\* prot., datë 09.01.2018, drejtuar ZVRPP-së Tiranë dhe për dijeni ZQRPP-së Tiranë dhe përgjigjen e ardhur me nr. \*\*\* prot., datë 26.01.2018.

Shkresën nr. \*\*\* prot., datë 09.01.2018, përgjigjen nr. \*\*\* prot., datë 22.02.2018.

Shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.02.2018, me përgjigjen e ardhur nr. \*\*\*, datë 22.02.2018.

Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 02.03.2018, drejtuar ZVRPP-së Tiranë dhe përgjigjen e ardhur nr. \*\*\* prot., datë 27.03.2018.

<sup>14</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 28.02.2018, drejtuar ZVRPP-së Tiranë dhe përgjigja e ardhur me nr. \*\*\*, datë 20.03.2018.

<sup>15</sup>Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 19.02.2018, drejtuar 16 bankave për shtetasin T. L. Përgjigjen me nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2018, ardhur nga “Intesa Sanpaolo Bank”, shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.03.2018, ardhur nga “Tirana Bank”, nga ku jepen të dhëna në lidhje me subjektin.

<sup>16</sup>Shiko në dosje shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.02.2018, drejtuar ZVRPP-së Pogradec dhe përgjigjen nr. \*\*\* prot., datë 20.03.2018.

konfirmohet fakti se për pasurinë në fjalë nuk është bërë pajisja me certifikatë për vërtetim pronësie e pronarit dhe, për rrjedhojë, nuk ka të dhëna të tjera në arkiv. Regjistrimi është bërë sipas “Regjistrimit fillestar”, sipas aktit të marrjes së tokës në pronësi nr. \*\*\*, datë 06.05.1998, në emër të “A. S. Sh”, dhe bashkangjitur ZVRPP-ja Pogradec përcjell kopje të kartelës së pasurisë. Subjekti ka deklaruar se nuk është kryer ende kalimi i pronësisë në regjistrin e ZVRPP-së Pogradec për arsye të mosnxjerrjes së dëshmisë së trashëgimisë nga pala shitëse e pasurisë.

#### ❖ Arsyetimi ligjor

Nga analiza financiare e balancës së të ardhurave me shpenzimet për vitin 2014, si më poshtë:

Nr.	ANALIZA FINANCIARE	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015
1	Të ardhurat	<b>2.187.909</b>	<b>2.428.784</b>	<b>2.194.937</b>
	Të ardhura nga paga dhe honorarë të tij	1.674.185	1.739.743	1.681.057
	Nga paga e bashkëshortes	513,724	338,766	513,880
	Nga shitja e automjetit tip “Benz”, targë ***		350,275	
2	Pasuritë	<b>635,597</b>	<b>760,257</b>	<b>459,474</b>
	Tokë bujqësore sip. 2000 m <sup>2</sup> , ***, Pogradec		851,000	
	Shtuar gjendja e likuiditeteve	635.597	-90.743	459.474
3	Detyrimet	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
4	Shpenzimet	<b>1.390.059</b>	<b>1.260.001</b>	<b>1.303.353</b>
	Për arsimimin e vajzës në kolegjin “****”	483.725	483.380	478.334
	Shpenzime jetike sipas ILDKPKI	750.000	750.000	750.000
	Për udhëtime jashtë vendit	156.334	26.621	75.019
5	Diferenca	<b>162.253</b>	<b>408.526</b>	<b>432.110</b>

- rezulton që ajo të jetë pozitive dhe, për rrjedhojë, subjekti ka disponuar mjete financiare të mjaftueshme për të justifikuar kryerjen e këtij transaksioni.

Deklarimi i subjektit është i saktë dhe rezultojnë të ardhura financiare të mjaftueshme për kryerjen e këtij investimi.

#### **8. Mjeti me targë \*\*\*, blerë në Tiranë, me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.04.2016.**

##### **Burimi i krijimit:**

- Kursimet nga të ardhurat prej punës së deklaruesit dhe bashkëshortes.

##### **Çmimi i deklaruar: 6.200 euro (blerja, zhdoganimi dhe targimi).**

Nga korrespondenca e kryer me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor konfirmohet se subjekti ka në pronësi mjetin me targë \*\*\* dhe ka pasur në pronësi deri më 13.10.2015 mjetin me targë \*\*\* (\*\*\*). Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës kontratën e shitblerjes së automjetit, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.04.2016.

Në lidhje me mjetin<sup>17</sup> me targë T\*\*\*, subjekti ka paraqitur kontratën e shitjes së automjetit, si palë shitëse, me nr. \*\*\* prot., nr. \*\*\* kol., datë 30.09.2014, para noterit Th. B në Pogradec, në vlerë 2.500 euro.

Mjeti me targë \*\*\* është blerë në Tiranë me kontratën nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 20.04.2016, i llojit “Mercedes E 220 CDI Sedan”, me vlerë 5.000 euro. Bashkëlidhur ndodhet dhe deklarata e zhdoganimit të automjetit.

#### ❖ Arsyetimi ligjor

Nga analiza financiare e balancës të ardhura - shpenzime të subjektit për vitin 2015, si më poshtë:

#### Vitet 2013, 2014 dhe 2015

Nr.	ANALIZA FINANCIARE	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015
1	Të ardhurat	<b>2.187.909</b>	<b>2.428.784</b>	<b>2.194.937</b>
	Të ardhura nga paga dhe honorarë të subjektit të rivlerësimit	1.674.185	1.739.743	1.681.057
	Nga paga e bashkëshortes	513.724	338.766	513.880
	Nga shitja e automjet tip “Benz”, me targë ***		350.275	
2	Pasuritë	<b>635.597</b>	<b>760.257</b>	<b>459.474</b>
	Tokë bujqësore, sip. 2000 m <sup>2</sup> , ***, Pogradec		851.000	
	Shtuar gjendja e likuiditeteve	635.597	-90.743	459.474
3	Detyrimet	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
4	Shpenzimet	<b>1.390.059</b>	<b>1.260.001</b>	<b>1.303.353</b>
	Për arsimimin e vajzës në kolegjin “***”	483.725	483.380	478.334
	Shpenzime jetike sipas ILDKPKI	750.000	750.000	750.000
	Për udhëtime jashtë vendit	156.334	26.621	75.019
5	Diferenca	<b>162.253</b>	<b>408.526</b>	<b>432.110</b>

Rezulton se subjekti është me rezultat pozitiv, çka do të thotë se ai ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar blerjen e automjetit me targë \*\*\*.

#### 9. Shtëpi banimi, apartament me sipërfaqe 78.4 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, Tiranë, Rruga e \*\*\*, h. \*\*\*, ap. \*\*\*. Blerë me kontratën e shitblerjes me rezervë nr. \*\*\* rep. dhe \*\*\*, datë 13.5.2016. Vlera: 75.000 euro.

##### Burimi i krijimit:

- Kursime nga të ardhurat prej punës së deklaruesit dhe bashkëshortes 25.000 euro.
- Hua A. M dhe A. H (bashkëshortë, vëllai dhe kunata e E. M, bashkëshortja e subjektit) në shumën 15.000 euro. Burimi është nga kursimet e tyre prej punës në kompaninë “\*\*\*”, në pronësi të babait të A. H dhe menaxhimi i dy dyqaneve, shitja me shumicë dhe pakicë, mobilieri me sip. 2000 m<sup>2</sup> dhe 3600 m<sup>2</sup> ndodhur në qytetin \*\*\*, Turqi. Shuma është transferuar nëpërmjet Bankës Kombëtare Tregtare në datën 16.05.2016.

<sup>17</sup> Për më tepër shiko në dosje të KPK shkresën nr. \*\*\* prot.datë 05.01.2018 drejtuar DPSHTRR dhe përgjigjen e ardhur me nr. \*\*\*prot datë 22.01.2018 dhe përgjigjen me nr. \*\*\*prot.datë 12.01.2018..

- Kredi bankare pranë Bankës Kombëtare Tregtare, dega Stacioni i Trenit, në datën 05.12.2016 në shumën 1.500.000 lekë.

### Hetimi i kryer nga Komisioni

Nga korrespondenca me ZQRPP-në<sup>18</sup> dhe ZVRPP-në Tiranë konfirmohet apartamenti me sipërfaqe 78.40 m<sup>2</sup>, në pronësi të subjektit Besnik Muçi, regjistruar me nr. \*\*\*zk. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*. Në seksionin “E” të kartelës së pasurisë, konfirmohet bllokimi i pasurisë në favor të shitësit deri në likuidimin e plotë të shumës, sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 16.5.2016 + praktika.

ZVRPP-së Tiranë i është kërkuar praktika e regjistrimit të pasurisë së cituar, si dhe gjendja juridike aktuale e pasurisë.

Shoqëria “\*\*\*” sh.p.k.<sup>19</sup> konfirmon pagesat e kryera nga subjekti në favor të saj, nëpërmjet transfertave bankare në shumën 40.000 euro nga llogaria e noteres, datë 16.05.2016, si dhe shumën 14.000 euro likuiduar në numrin e llogarisë së shoqërisë pranë “Credins Bank”, më datë 6.12.2016. Detyrimi i mbetur pa likuiduar është në vlerën 21.000 euro.

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit<sup>20</sup> të Parave konfirmon se Besnik Muçi, i datëlindjes 16.01.1973, vendlindja Pogradec, me nr. identifikimi \*\*\*, më datë 16.05.2016, ka investuar te shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., NIPT \*\*\*, në vlerën 40.000 euro.

Në lidhje me burimin: “Kursime nga të ardhurat prej punës së deklaruesit dhe bashkëshortes 25.000 euro”, nga analiza e deklarimeve të gjendjes *cash*, kursimeve dhe e lëvizjeve në llogaritë bankare të subjektit, nuk ka dyshime mbi ligjshmërinë e këtyre të ardhurave. Rezulton se nga gjendja e likuiditeteve *cash* në shtëpi, të deklaruara në fund të vitit 2015, ka konvertuar në monedhën euro shumën prej 15.000 eurosh dhe i ka depozituar në “BKT” më datë 16.05.2016. Po në këtë datë, subjekti ka mbyllur depozitën me afat në “BKT” dhe ka transferuar në llogarinë rrjedhëse në “BKT” shumën prej 10.012 eurosh.

Sipas kontratës së shitblerjes me rezervë, me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.05.2016, neni ”Të drejtat e detyrimet e shitësit” është e qartë se vlera e apartamentit në shumën prej 75.000 eurosh do të bëhet me këste, nëpërmjet kalimit të numri i llogarisë së noteres. Shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.02.2018, deklaroi se subjekti ka paguar vlerën prej 40.000 eurosh nëpërmjet llogarisë bankare të noteres.

Më 06.12.2016, në llogarinë e shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. pranë “Credins Bank” është likuiduar shuma prej **14.000 eurosh**, me burim të ardhurash:

- Më 05.12.2016, subjekti ka marrë kredi në “BKT” shumën 1.500.000 lekë (disbursuar në llogarinë bankare nr. 402409680) dhe më datë 06.12.2016 B. Muçi ka tërhequr *cash* shumën **1.550.000** lekë.
- Në plotësimin e shumës prej 14.000 eurosh përfshihen edhe kursime nga të ardhurat nga paga e subjektit gjatë vitit 2016.

<sup>18</sup>Shiko në dosje shkresën nr. \*\*\* prot., datë 05.01.2018, me përgjigjet e ardhura nr. \*\*\*, datë 26.01.2018 dhe nr. \*\*\*, datë 29.01.2018. Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 19.02.2018 dhe përgjigjja nr. \*\*\*prot., datë 15.03.2018.

Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 05.04.2018 dhe përgjigjja e ardhur nga ZQRPP nr. \*\*\*prot., datë 16.04.2018.

<sup>19</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 08.02.2018, drejtuar shoqërisë “\*\*\*”sh.p.k. dhe përgjigjja e ardhur nr. \*\*\* prot., datë 10.02.2018.

<sup>20</sup>Shkresa me nr. \*\*\* prot., datë 05.01.2018, drejtuar DPPP-së me përgjigjen e ardhur nr. \*\*\*prot., datë 22.01.2018.



- Është pyetur subjekti, në pyetësin nr. 2, nëse e njeh personalisht shtetasin A. L, administrator i shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., rrethanat si është njohur dhe çfarë marrëdhëniesh ka me këtë person.

Subjekti, në përgjigjen e tij, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 20.04.2018, sqaron se e njeh dhe ka marrëdhënie shoqërore me shtetasin A. L sepse vijnë të dy nga Pogradeci, por deklaron se nuk ka marrëdhënie biznesi dhe nuk ka qenë ndonjëherë në kushtet e konfliktit të interesit me këtë person.

- Në lidhje me huan e marrë nga A. M dhe A. H (bashkëshortë, vëllai dhe kunata e E. M, bashkëshortja e subjektit) në shumën 15.000 euro<sup>21</sup>, subjekti ka bashkëlidhur dokumentacionin justifikues ligjor në dosjen e ILDKPKI-së, me të dhëna banimi dhe punësimi nga A. M dhe e shoqja, në Turqi. Shuma është transferuar nëpërmjet Bankës Kombëtare Tregtare në datën 16.5.2016, çka do të thotë se kemi të bëjmë me një transfertë nga banka në bankë, duke u legjitimuar kështu burimi i të ardhurave që justifikon këtë gjendje financiare në bankën e origjinës prej nga është bërë transfertat.

Pas pyetjes se bërë nga Komisioni, subjekti ka paraqitur dokumentacion nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Turqi, Drejtoria e Përgjithshme e Pensionit në Turqi, që konfirmon se A. M është i siguruar për periudhën mars 2012 deri në shkurt 2018, kurse shtetasja A. H. M figuron e siguruar prej muajit dhjetor 2006. Ky dokumentacion rezulton i përkthyer dhe i noterizuar nga noteri E. M, përkatësisht me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* rep., datë 18.04.2018.

Nga korrespondenca e kryer me ZVRPP-në Tiranë, me shkresën nr. \*\*\*, datë 06.06.2018, rezulton se kjo pasuri është blerë nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 08.03.2016, nga shtetasit E. Sh dhe G.H, për shumën 74.500 euro dhe në datën 13.05.2018, pra 2 muaj e 5 ditë më vonë, kjo pasuri i është shitur blerësit Besnik Muci për shumën 75.000 euro.

- Komisioni kreu hetim në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit dhe është proceduar me pyetjen e subjektit në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit nga vetë ai, si dhe çmimin e blerjes nga shoqëria.

Subjekti ka shpjeguar se: *“Sikurse e vërteton edhe kontrata, pagesën e kam shpërndarë me këste për shkak të paafësisë paguese, kurse në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit nga shoqëria, nuk kam dijeni”.*

- Në lidhje me pyetjen nëse i njeh shtetasit E. Sh dhe G. H, subjekti sqaron se nuk ka marrëdhënie që lidhen me punën e tij si prokuror, por vetëm është takuar me bashkëshorten e tij me ta si ish-pronarë të banesës për sqarime në lidhje me rrjetin elektrik, ajrosjen ujin, pagesat e administrimit të pallatit.

Komisioni, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.06.2018, ka kryer korrespondencë me Prokurorinë e Përgjithshme duke kërkuar çdo të dhënë, kopje të fashikujve të procedimeve penale të mosfilluara, të pushuara apo pezulluara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Prokuroria e Përgjithshme, për shtetasit A. L, E. Sh dhe G. H.

Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.06.2018, konfirmon se nuk ka kallëzime apo procedime penale të regjistruara për shtetasit e sipërcituar.

<sup>21</sup>Shiko përgjigjen e pyetësorit, datë 19.04.2018, në dosje të Komisionit.

Nga analiza financiare për vitin 2016, si më poshtë:

	ANALIZA FINANCIARE	2016
1	<b>Te ardhurat</b>	<b>2 066 185</b>
	Paga dhe honorare të subjektit	1 632 627
	Paga e bashkëshortes	513 880
	Nga qiraja e apartamentit	120 000
2	<b>Pasuritë</b>	<b>7 068 900</b>
	Pakësim i likujditeteve të deklaruara CASH	- 3915 024
	Blerje e apartamentit	10 145 250
	Blerje e autoveturës	838 674
3	<b>Detyrimet</b>	<b>6 529 720</b>
	Marrë borxh A. M dhe A. H ( 15 000 Euro x 135.27)	2 029 050
	Kredi bankare	1 500 000
	Detyrim ndaj shoqërisë së ndërtimit ( 21 000 euro x 135.27)	2 840 670
	Overdraft	160 000
4	<b>Shpenzimet</b>	<b>1.418,200</b>
	Arredimi i apartamentit	468.000
	Shpenzime jetese sipas ILDKPI	750,000
	Shpenzime udhëtimi jashte shtetit	37,876
	Shpenzime për arsimimin e vajzës në ***	162.324
	<b>Diferenca</b>	<b>108,805</b>

Subjekti rezulton me balancë financiare pozitive.

#### ❖ Arsyetimi ligjor

Në bazë të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës: *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore...”*.

Në lidhje me ligjshmërinë e burimeve të të ardhurave që janë përdorur për blerjen e apartamentit, konkretisht:

- kursime nga të ardhurat prej punës së deklaruesit dhe bashkëshortes, 25.000 euro.
- hua A. M dhe A. H (bashkëshortë, vëllai dhe kunata e E. M, bashkëshortja e subjektit) në shumën 15.000 euro. Burimi është nga kursimet e tyre prej punës në kompaninë “\*\*\*”. Shuma është transferuar nëpërmjet Bankës Kombëtare Tregtare në datën 16.5.2016.
- kredi bankare pranë Bankës Kombëtare Tregtare, dega Stacioni i Trenit, në datën 05.12.2016 në shumën 1.500.000 lekë,

duke marrë në konsideratë analizën e llogarive bankare, deklaramet e subjektit, korrespondencën me institucione të ndryshme, nuk ka dyshime në lidhje me ligjshmërinë e burimit të këtyre të ardhurave monetare.

**10. Detyrim ndaj shoqërisë së ndërtimit “\*\*\*” sh.p.k.,** me përfaqësues z. Armand N. L, lindur për shkak të blerjes së shtëpisë së banimit, apartament 78.4 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\* Tiranë, Rruga e \*\*\*, hyrja \*\*\*, ap. \*\*\*. Blerë me kontratën nr. \*\*\* rep. dhe \*\*\*, datë 13.5.2016. Detyrimi ka lindur në datën 13.5.2016 dhe sipas kontratës do të likuidohet brenda muajit maj të vitit 2019. Shuma e mbetur e detyrimit është pa interes deri në datën e likuidimit në vlerën 21.000 euro.

*Nuk ka dyshime në lidhje me ekzistencën e këtij detyrimi, shumën e paguar dhe shumën e mbetur pa paguar.*

**11. Detyrim ndaj shtetasve A. M dhe A. H (bashkëshortë, vëllai dhe kunata e E. M, bashkëshortja e subjektit)** të cilët banojnë në qytetin \*\*\*, Turqi. Shuma është dhënë hua dhe është transferuar nëpërmjet Bankës Kombëtare Tregtare, në datën 16.5.2016. Detyrimi ka lindur në datën 16.5.2016 dhe do të shlyhet deri në datën 16.5.2022. Huaja është pa interes. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer, 15.000 euro.

*Nuk ka dyshime në lidhje me ekzistencën e këtij detyrimi.*

**12. Detyrim ndaj Bankës Kombëtare Tregtare** për shkak të marrjes së kredisë konsumatore për *overdraft*-e lidhur me Bankën Kombëtare Tregtare, dega “Ismail Qemali”, në datën 22.04.2016. Norma e interesit është 13.3 % mbi bazë vjetore. Detyrimi ka lindur në datën 22.4.2016 dhe do të likuidohet brenda datës 05.03.2017. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer, 160.000 lekë.

*Nuk ka dyshime në lidhje me ekzistencën e këtij detyrimi.*

**13. Detyrim ndaj Bankës Kombëtare Tregtare** për shkak të marrjes së kredisë, e lidhur me Bankën Kombëtare Tregtare, dega “Stacioni i Trenit”, në datën 05.12.2016. Norma e interesit është 7.5 %, mbi bazë vjetore. Detyrimi ka lindur në datën 05.12.2016 dhe do të likuidohet brenda datës 06.12.2021. Kësti mujor i pagesës është 30.196 lekë. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer, 1.500.000 lekë.

*Nuk ka dyshime në lidhje me ekzistencën e këtij detyrimi, shumën e paguar dhe shumën e mbetur pa paguar.*

## **14. Konstatime të tjera**

### **14.1 Të dhëna nga Regjistri Noterial Shqiptar pranë Ministrisë së Drejtësisë**

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Nga korrespondenca e kryer me Ministrinë e Drejtësisë<sup>22</sup> në lidhje me pasuri të paregjistruara në ZVRPP të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, rezultojnë kontrata noteriale të deklaruara nga subjekti, si dhe kontratë shitjeje, dhurimi, kalim pronësie, e lidhur

<sup>22</sup> Shiko për më tepër shkresën nr. \*\*\* prot., datë 05.01.2018 drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe përgjigjen e ardhur me nr. \*\*\* prot., datë 22.01.2018.

më datë 05.01.2018, me datë regjistrimi 11.01.2018 dhe nr. \*\*\* shërbimi, ku njëra nga palët kontraktore është shtetasja E. Z. M, bashkëshortja e subjektit.

Komisioni ka kërkuar pranë noterit publik, z. S. R, në Pogradec praktikën e plotë të kontratës noteriale.

Me vërtetimin nr. \*\*\* rep., datë 31.05.2018, noteri S. R konfirmon kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*rep., e nr. \*\*\* kol., datë 05.01.2018, ku shitësit V., E., I., A. M, - të cilët sipas verifikimit të kryer nga noteri në ZVRPP-në Pogradec rezultojnë të kenë në pronësi në pjesë të barabartë e të pandarë një pasuri të llojit “truall” me sip. truall 178 m<sup>2</sup> dhe sip. ndërtese 100 m<sup>2</sup>, - ia shesin këtë pasuri blerësit E. M, për çmimin 1.300.000 lekë.

Në përfundim të hetimit administrativ, rezultoi se kjo pasuri, për shitjen e së cilës ka firmosur në cilësinë e bashkëpronares edhe bashkëshortja e subjektit, nuk rezulton e deklaruar, si nga subjekti, ashtu edhe nga personi i lidhur/ bashkëshortja e subjektit, as në deklaratën “Vetting” dhe as në deklaratat periodike/vjetore të pasurisë në ILDKPKI, e për rrjedhojë nga Komisioni është konsideruar se kemi të bëjmë me pamjaftueshmëri në deklaram.

- Është pyetur subjekti se përse kjo pasuri, - ku figuron se një nga shitësit e për rrjedhojë bashkëpronare në pjesë të barabartë, por të pandarë, është edhe bashkëshortja e tij, znj. E. M, - nuk është deklaruar në deklaratat e pasurisë në ILDKPKI.

Subjekti, në përgjigjen e tij sqaron se: *“Prona e mësipërme është ndërtuar mbi truallin e dhënë nga shteti, rreth vitit 1985, nga babai i bashkëshortes sime, shtetasi Z. M, kur bashkëshortja ime ka qenë rreth 10 vjeçe. Në vitin 1997, ne jemi martuar dhe bashkëshortja ime është shkëputur nga familja e saj. Kjo pronë ka qenë e regjistruar në ZVRPP-në Pogradec, me pronar shtetasin Z. M, vërtetuar kjo me certifikatën për vërtetim pronësie lëshuar nga kjo zyrë më datë 01.03.2018.*

*Në datën 05.01.2018, vjehri im ka shkuar për të shitur këtë pasuri te noteri S. R, Pogradec. Noteri, duke e konsideruar një pjesë të kësaj prone, truallin mbi të cilin është ndërtuar shtëpia, si pronë të familjes bujqësore, pasi i është dhënë familjes nga shteti pa shpërblim para vitit 1991, i ka kërkuar që, për ta konsideruar të vlefshme shitjen, duhet të firmosnin si bashkëpronarë në këtë shitje të gjithë pjesëtarët e kësaj familjeje në vitin 1991, sipas certifikatës së gjendjes civile. Prandaj në kontratë kanë firmosur prindërit e bashkëshortes sime, vëllai dhe motra e saj, sipas certifikatës bashkangjitur kontratës, të cilin noteri në paragrafin e parafundit të faqes së dytë të kontratës e përcakton si “...certifikata e përbërjes familjare të përfaqësuesit të kësaj familjeje bujqësore...”.*

*Në kushtet e mësipërme, duke pasur në konsideratë faktin që shtëpia është ndërtuar rreth vitit 1985, bashkëshortja ime është larguar nga familja e saj para 21 vjetësh, në vitin 1997, ne nuk e kemi konsideruar asnjëherë bashkëpronësinë e bashkëshortes në këtë pronë, por e kemi parë si një pronë të prindërve të saj. Nuk kemi përfituar asnjëherë fruta civile nga kjo pronë”.*

Gjithashtu, në seancën dëgjimore të datës 30.07.2018, subjekti ka dhënë sqarime shtesë, duke deklaruar se:

- *“Truall për ndërtimin e shtëpisë, me sipërfaqe 178 m<sup>2</sup>, nuk është dhënë nga shteti pa shpërblim në vitin 1991, siç thuhet në raport, por rreth vitit 1985, kur dhe është ndërtuar banesa (para vitit 1991 vetëm shteti ishte pronar i pasurive të paluajjtshme në Shqipëri).*

- *Fakti i bashkëpronësisë në pjesë të barabarta në këtë pronë (truall + banesë) i të gjithë pjesëtarëve të familjes bujqësore të z. Z. M, në vitin 1991, sipas shpjegimeve të noterit, nuk qëndron. Mund të diskutohet vetëm bashkëpronësia e truallit. Kjo për shkak se trualli i është dhënë nga shteti për ndërtim rreth vitit 1985 familjes bujqësore të z. Z. M. Automatikisht kjo pronë, truall ndërtimi 178 m<sup>2</sup>, është në bashkëpronësi në pjesë të barabarta të pjesëtarëve të familjes bujqësore të z. Z. M, në vitin 1985, rrjedhimisht dhe e bashkëshortes ime që ka qenë 10 vjeçe. Duke marrë të mirëqenë këtë fakt, rezulton që me çmimin e sotëm bashkëshortja ime mund të jetë bashkëpronare në këtë pasuri me vlerë rreth 40.000 lekë (çmim tregu rreth 1.000-1.200 lekë/m<sup>2</sup>).*
- *Banesa është ndërtuar me punën dhe kontributin e prindërve të bashkëshortes së subjektit, Z. e V. M rreth vitit 1985 dhe, rrjedhimisht, këta të dy janë bashkëpronarë të saj. Sipas rregullimit të Kodit Civil të kohës, por edhe sot për bashkëpronësinë nuk mund të konsiderohen automatikisht bashkëpronarë në një pronë të krijuar persona që janë pjesëtarë të familjes, por që nuk kanë dhënë asnjë kontribut, sikurse jua ka shpjeguar noteri. Në rastin tonë, nuk mund të konsiderohen automatikisht bashkëpronarë pjesëtarët e familjes, fëmijët rreth moshës 10 vjet (E. M), 5 vjet (I. M) dhe 3 vjet (A. M), të bashkëshortëve Z. e V. M në pronën e krijuar pre tyre.*
- *Duke marrë në konsideratë sa më sipër, vlerësoj që në rastin e kësaj prone nuk kemi të bëjmë me mosdeklarim/fshehje pasurie që gjatë 21 viteve të martesës sonë as nuk e kemi disponuar, as nuk e kemi poseduar dhe as nuk e kemi gëzuar, unë ose bashkëshortja ime. Edhe vetë afati maksimal i fitimit të pronësisë së pasurisë së paluajtshme me parashkrim është 20 vjet. Madje, shuma e shitjes së kësaj pasurie ndodhet ende në llogarinë e vjehrrit tim.”.*

#### ❖ Arsyetimi ligjor

Regjistrimi i shtëpive të ndërtuara në zonat urbane të fshatrave, rrjedhimisht edhe shtëpia e banimit e shtetasit Z. M, është regjistruar në ZVRPP-në Pogradec, në bazë të VKM-së nr. 432, datë 14.08.1995, “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit”, që trajton regjistrimet e truallit vetëm në funksion të një ndërtimi ekzistues para datës 10.08.1991, në referim të paragrafit të fundit të nenit 21 të ligjit nr. 7512, datë 10.08.1991, “Për mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”.

Në paragrafin e fundit të nenit 21 të ligjit nr. 7512, datë 10.08.1991, sanksionohet se: “*Personat juridikë a fizikë, pronarë të ndërtesave ekzistuese të çdo lloji, janë edhe pronarë të truallit që zënë këto ndërtesa.*”

Në pikën 2 të VKM-së nr. 432, datë 14.08.1995, përcaktohet se: “*Madhësia e sipërfaqes së truallit në pronësi të pronarit të ndërtesës që ka kryer ndërtimin mbetet ajo që është miratuar sipas dispozitave ligjore ekzistuese deri në daljen e ligjit nr. 7633, datë 7.4.1993, “Për urbanistikën”.*”

Në ligjin nr. 6340, datë 26.06.1981, “Kodi Civil i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”: a) në nenin 77 (*pronësia vetjake*), përcaktohet se: “**Janë pronë vetjake të ardhurat nga puna dhe nga burime të tjera të ligjshme, shtëpia e banimit dhe sende të tjera, që shërbejnë për plotësimin e nevojave materiale e kulturore vetjake e familjare**”.

Në nenet 86, 87 (*bashkëpronësia ndërmjet bashkëshortëve*) përcaktohet se:

- a) Neni 86 - “Sendet, depozitat në arkat e kursimit dhe çdo gjë tjetër e fituar nga bashkëshortët gjatë martesës janë në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve.”;

- b) Neni 87 - “Veprimet juridike, të kryera nga cilido bashkëshort në lidhje me sendet e përbashkëta të tyre, janë të vlefshme edhe kur janë kryer pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër. **Por, tjetërsimi i pasurive të përbashkëta të paluajtshme duhet të bëhet gjithmonë me pëlqimin e të dy bashkëshortëve**”.

Në dekretin nr. 5747, datë 29.06.1978, të Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, i ndryshuar:

- a) Në nenin 9, përcaktohet se: “Në fshatra, me qendra të tjera të banuara, brenda **tyre lejohet ndërtimi i banesave të reja vetjake**, si rregull, me të ardhurat e vetë shtetasit dhe, në raste të caktuara, me kredi bankare sipas dispozitave të veçanta...”.
- b) Në nenin 13, përcaktohet se: “**Tjetërsimi i banesave, pronë vetjake**, në qytete bëhet me leje të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të qytetit ose të këshillit popullor të qytetit, kur nuk ka komitet ekzekutiv, të lagjes për qytetin e Tiranës dhe në fshatra me leje të këshillit popullor të fshatit të bashkuar”.

Edhe në rast se personin e lidhur, znj. E. M, do ta konsideronim anëtare të familjes bujqësore të përfaqësuesit të saj, z. Z. M, në një analizë të:

1) Kodit Civil (*miratuar me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994; ndryshuar me ligjet nr. 8536, datë 18.10.1999; nr. 8781, datë 03.05.2001 dhe nr.17/2012, datë 16.02.2012; 121/2013, datë 18.04.2013*), seksioni B (*bashkëpronësia midis anëtarëve të familjes bujqësore*), neni 222, citojmë: “*Pronësia mbi pasurinë e anëtarëve të familjes bujqësore u përket në tërësi anëtarëve të saj, të cilët nëpërmjet punës ose të drejtave të tjera të fituara, kanë kontribuar në krijimin e në mbajtjen e ekonomisë bujqësore*” si dhe:

2) Ligjit 8337, datë 30.04.1998, “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”, neni 5, citojmë: “*Familja bujqësore që i kalon pronësinë e saj mbi tokën bujqësore, pyjore, livadhet, kullotat çdo shtetasi, personi fizik dhe juridik vendas, në përputhje me kërkesat ligjore për kalimin e pasurisë së paluajtshme, paraqet në zyrën e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme dokumentet vijuese:*

a) *Certifikatën e vërtetimit të pronësisë së zyrës së regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, shoqëruar me aktin noterial për kalimin e pronësisë dhe hartën treguese të vendndodhjes së pronës.*

b) *Aktet që vërtetojnë përbërjen e familjes bujqësore, në çastin e kalimit të pronësisë, të vërtetuar nga certifikata e gjendjes civile, vërtetimi i pushtetit lokal dhe deklarata e përbashkët e anëtarëve të familjes*”,

si edhe në një interpretim të jurisprudencës në lidhje me konceptin e familjes bujqësore, është më se e qartë se familja bujqësore është një grupim, përbërja e së cilës është në ndryshim të vazhdueshëm, ku hyjnë dhe dalin anëtarë për shkak të veprimeve të caktuara juridike (*vajza që martohet del nga familja bujqësore dhe nusja që vjen bëhet pjesë e familjes bujqësore, djali që shkëputet nga trangu familjar del nga familja bujqësore*), si edhe për shkak të ligjit.

Për rrjedhojë, personi i lidhur, znj. E. M, me martesën e kryer me z. Besnik Muçi, e ka humbur statusin e anëtares së familjes bujqësore të përfaqësuesit të saj, z. Z. M.

Pra, edhe në rast se shtëpinë e banimit të z. Z. M do ta konsideronim si pasuri në pronësi të familjes bujqësore, përsëri znj. E. M nuk gëzon më statusin e anëtares së familjes bujqësore, duke mos pasur asnjë të drejtë pronësie mbi të në momentin e tjetërsimit të pasurisë nga prindërit e saj.

Sa më sipër, pronësia e shtëpisë së banimit (*përfshirë edhe pronësinë mbi truallin*) nuk gjen rregullim ligjor në ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën” dhe as në ndonjë legjislacion

tjetër, në mënyrë që të mund të trajtohet si një pasuri e familjes bujqësore, e krijuar me kontributin e anëtarëve të familjes bujqësore. Përkundrazi, legjislacioni i mësipërm konfirmon faktin se kemi të bëjmë me një pasuri të krijuar nga një person fizik, nga kontributi i përbashkët i dy bashkëshortëve si një pasuri bashkëshortore në bashkëpronësi ose nga disa bashkëpronarë, por jo si produkt i familjes bujqësore.

Pavarësisht firmosjes nga ana e personit të lidhur me subjektin (*bashkëshortja e tij*) në kontratën e shitblerjes së shtëpisë së banimit, kemi të bëjmë me një interpretim të gabuar të ligjit nga noteri publik, duke e konsideruar shtëpinë e banimit në fshat të regjistruar në ZVRPP-në Pogradec në përputhje me VKM-në nr. 432, datë 14.08.1995, si një pasuri në pronësi të familjes bujqësore. Për rrjedhojë, si subjekti, ashtu edhe personi i lidhur me të, nuk kanë pasur detyrimin ligjor të deklarojnë këtë pasuri në deklaratat përkatëse të pasurisë ndër vite apo në deklaratën “Vetting”.

#### **14.2 Pasuri të paluajtshme të regjistruara në pronësi të z. Z. M si përfaqësues i familjes bujqësore (*babai i bashkëshortes së subjektit, personit të lidhur, znj. E. M*).**

##### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Nga korrespondenca e kryer me ZVRPP-në në lidhje me pasuri të regjistruara në pronësi të disa personave, përfshirë edhe z. Z. M, ZVRPP-ja Pogradec, me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 11.01.2018, konfirmon se në emër të shtetasit Z. H. M, i datëlindjes 07.04.1941, ekzistojnë pasuritë e mëposhtme:

1. pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK \*\*\*, \*\*\*, e llojit “arë”, me sip. 1092 m<sup>2</sup> sipas AMTP-së dhe sip. 1071 m<sup>2</sup> sipas LN, statusi “familjare”, me datë lëshimi certifikate pronësie 01.03.2008;
  2. pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK \*\*\*, \*\*\*, e llojit “arë”, me sip. 1120 m<sup>2</sup>, statusi “familjare”, me datë lëshimi certifikate pronësie 01.03.2008;
  3. pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK \*\*\*, \*\*\*, e llojit “arë”, me sip. 2177 m<sup>2</sup> sipas AMTP-së dhe sip. 2120 m<sup>2</sup> sipas LN, statusi “familjare”, me datë lëshimi certifikate pronësie 01.03.2008;
  4. pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK \*\*\*, \*\*\*, e llojit “arë”, me sip. 2000 m<sup>2</sup> sipas AMTP-së dhe sip. 1995 m<sup>2</sup> sipas LN, statusi “Familjare”, me datë lëshimi certifikate pronësie 01.03.2008;
  5. pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK \*\*\*, \*\*\*, e llojit “arë”, me sip. 1092 m<sup>2</sup> sipas AMTP dhe sip. 1071 m<sup>2</sup> sipas LN, statusi “familjare”, me datë lëshimi certifikate pronësie 01.03.2008;
  6. pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK \*\*\*, \*\*\*, e llojit “arë”, me sip. 600 m<sup>2</sup> sipas AMTP dhe sip. 1071 m<sup>2</sup> sipas LN, statusi “familjare”, me datë lëshimi certifikate pronësie 01.03.2008.
- Nga korrespondenca me Bashkinë Pogradec, Njësia Administrative \*\*\*, me shkresën nr. 188/1 prot., datë 08.06.2018, konfirmohet se në përbërjen familjare të shtetasit Z. H M, më datë 01.08.1991, rezulton anëtare e familjes bujqësore edhe znj. E. M, e bija e Z. dhe V., e datëlindjes \*\*\*.
  - Është pyetur subjekti nëse ka përfituar bashkëshortja nga ligji 7501 dhe, nëse po, përse nuk është deklaruar.

Subjekti sqaron se bashkëshortja e tij, si pjesë e familjes bujqësore, ka përfituar nga ligji nr. 7501 1/5-tën pjesë të kësaj prone, që është 2327 m<sup>2</sup> tokë bujqësore, por e regjistruar në ZVRPP është vetëm 1727 m<sup>2</sup>. Këto toka janë shfrytëzuar nga vjehri që nga momenti kur janë marrë

nga shteti. Bashkëshortja është larguar në vitin 1997 nga familja e saj dhe asnjëherë nuk janë përfituar fruta civile prej kësaj toke. Nuk ka pasur arsye apo qëllim për mosdeklarimin e kësaj pasurie, por këto toka janë shfrytëzuar nga vjehri që prej vitit 1991 dhe nuk është konsideruar asnjëherë bashkëpronësia e bashkëshortes në këto prona.

#### ❖ Arsyetimi ligjor

Tokat bujqësore të regjistruara në pronësi të z. Z. H. M, në cilësinë e përfaqësuesit të familjes bujqësore, janë përfituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”.

Në bazë të VKM-së nr. 255, datë 02.08.1991, “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, në pikën 2 përcaktohet se: “Në të gjitha rastet toka ndahet përpjesëtimisht për çdo familje, sipas numrit të frymëve të gjendjes civile në datën 1 gusht 1991”.

Në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994, i ndryshuar, në kapitullin “B”, “Bashkëpronësia midis anëtarëve të familjes bujqësore”, neni 222, përcaktohet se: “Pronësia mbi pasurinë e anëtarëve të familjes bujqësore u përket në tërësi anëtarëve të saj, të cilët nëpërmjet punës ose të drejtave të tjera të fituara, kanë kontribuar në krijimin e në mbajtjen e ekonomisë bujqësore”.

Në ligjin nr. 8337, datë 30.04.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”, neni 5 përcaktohet se:

*“Familja bujqësore që i kalon pronësinë e saj mbi tokën bujqësore, pyjore, livadhet, kullotat çdo shtetasi, personi fizik dhe juridik vendas në përputhje me kërkesat ligjore për kalimin e pasurisë së paluajtshme, paraqet në zyrën e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme dokumentet vijuese:*

*a) Certifikatën e vërtetimit të pronësisë së zyrës së regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, shoqëruar me aktin noterial për kalimin e pronësisë dhe hartën treguese të vendndodhjes së pronës.*

*b) Aktet që vërtetojnë përbërjen e familjes bujqësore në çastin e kalimit të pronësisë, të vërtetuar nga certifikata e gjendjes civile, vërtetimi i pushtetit lokal dhe deklarata e përbashkët e anëtarëve të familjes....”.*

Znj. E. M, më datë 01.08.1991, ka qenë anëtare e familjes bujqësore të përfaqësuesit të saj, z. Z. M, por në vitin 1997 ajo është shkëputur nga familja e saj bujqësore, duke mos qenë më pjesë e saj, për shkak të martesës me z. Besnik Muçi.

Në përfundim, duke marrë në konsideratë legjislationin e sipërcituar, në interpretim të të cilit është e qartë se familja bujqësore është një organizim ku hyjnë dhe dalin anëtarë të cilët përfitojnë ose lëshojnë pronësi në të, në bazë të kontributeve ose të drejtave të tjera të fituara për shkak të ligjit, znj. E. M, pavarësisht se në datën 01.08.1991 ka qenë anëtare e familjes bujqësore të z. Z. M, prej vitit 1997 kur ajo është shkëputur nga kjo familje për shkak të martesës me z. Besnik Muçi, ajo nuk mund të përfitojë të drejta pronësore mbi pasuritë e kësaj familjeje bujqësore (përveçse për shkaqe ligjore, si p.sh. trashëgimia), e për rrjedhojë, si subjekti i rivlerësimit, ashtu edhe znj. E. M, nuk kanë pasur detyrim ligjor për deklarimin e kësaj pasurie në ILDKPKI.

**14.3 Kontratë qiraje, nënshkruar më datë 5.9.2016, midis palëve qiradhënëse Besnik Muçi dhe qiramarrës R. S, të shtëpisë së banimit në rrugën “\*\*\*”. Vlera e qirasë mujore 24.000 lekë, afati i kontratës 1 vit. Detyrime të palaguara mbi të ardhurat personale.**



## Hetimi i kryer nga Komisioni

Nga Komisioni është hetuar në lidhje me pagesën e tatimit mbi të ardhurat e realizuara nga dhënia me qira e pasurisë<sup>23</sup> së subjektit, apartament me sip. 57 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK \*\*\*, Rr. “\*\*\*”, pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë.

Nga shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nr. \*\*\*, datë 25.04.2018, rezulton se tatimi i llogaritur për të ardhurat e tatueshme për dhënien me qira të apartamentit është 18.000 lekë në vitin 2016, shumë e cila nuk është paguar në afat.

Konstatohet se këto pagesa janë kryer pas dorëzimit të deklaratës “Vetting” nga ana e subjektit në ILDKPKI.

Subjekti, më 16 maj 2018 ka likuiduar shumën prej 23.171 lekësh, e përbërë nga 18.000 lekë tatim mbi të ardhurat nga qiraja e apartamentit, shuma 5.022 lekë gjobë për pagesë me vonesë, 49 lekë interes dhe 100 lekë komision.

Nga shkresa nr. \*\*\* prot., datë 01.03.2018, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, rezulton se nga verifikimi në arkiv dhe sistemin C@TS, shtetasi Besnik Muçi ka detyrime të papaguara në vlerën totale 406.349 lekë, detyrime këto që u përkasin deklarimeve individuale për vitin 2015 dhe vitin 2016.

Nga hetimi i Komisionit konstatohet se këto detyrime kanë rezultuar në sistem të papaguara, si pasojë e plotësimit të pasaktë të formularit të deklaramit individual të të ardhurave personale nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2015 dhe 2016. Subjekti ka lënë të paplotësuar në faqen përkatëse shumën e paguar si tatim mbi të ardhurat nga paga, respektivisht në vitin 2015 shuma 284.264 lekë dhe në vitin 2016 shuma 277.763 lekë, tatime këto që paguhen nga punëdhënësi dhe janë të pasqyruara në tabelën përmbledhëse të listëpagesave, kolona (TAP).

### ❖ Arsyetimi ligjor

Tatimi mbi të ardhurat është tatim që paguhet në burim nga punëdhënësi dhe, për rastin konkret, shumat përkatësisht 284.264 lekë në vitin 2015 dhe 277.763 lekë në vitin 2016, rezultojnë të paguara nga punëdhënësi dhe të pasqyruara në tabelën përmbledhëse të listëpagesave, kolona (TAP).

Tatimi mbi të ardhurat nga dhënia me qira e apartamentit është likuiduar jashtë afateve dhe për këtë shkak, nga ana e subjektit janë paguar edhe penaltetet përkatëse si gjobë dhe interesa për ditëvonesat, sipas parashikimeve në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.

Komisioni vlerësoi edhe faktin nëse për këto të ardhura është paguar tatimi, siç parashikohet në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Subjekti kishte detyrimin të paguante tatimin mbi të ardhurat personale në kuptim të pikës “dh” të nenit 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar. Por ky ligji nuk e pengon tatimpaguesin të shlyejë detyrimet tatimore edhe me vonesë dhe për këtë ai është i detyruar të paguajë gjobën përkatëse, që llogaritet nga organi tatimor.

---

<sup>23</sup>Shiko në dosje shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.02.2018, drejtuar DPT-së dhe DRT-së Tiranë dhe përgjigjen e ardhur me nr. \*\*\*prot., datë 01.03.2018. Shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 10.04.2018, dhe përgjigjen e ardhur me nr. \*\*\*prot., datë 23.04.2018, dhe nr. \*\*\*prot., datë 30.04.2018, ardhur nga DPT dhe DRT Tiranë.

Në vlerësimin e kësaj prove, Komisioni ka mbajtur parasysh se dispozitat e legjislacionit financiar nuk pengojnë pagimin e tatimit, përtej afatit të parashikuar. Nëpërmjet pagimit të tatimit nga subjekti, është përmbushur detyrimi ndaj buxhetit të shtetit, duke u ligjëruar kështu burimi i këtyre të ardhurave në favor të subjektit e për rrjedhojë nuk mund të konkludohet për shkelje ligjore që çojnë në shkarkimin e subjektit nga detyra.

#### 14.4 Analiza financiare

**Në vitin 2003 konstatohet një rezultat financiar me balancë negative prej 120 170 lekësh, sipas tabelës së përlllogaritjeve si më poshtë:**

*Viti 2003*

PËRSHKRIMI	2003
<b>Të ardhurat e dokumentuara</b>	<b>761.156</b>
Paga e subjektit	642.156
Paga e bashkëshortes	119.000
<b>PASURI</b>	<b>17.326</b>
Gjendje në bankë	17.326
<b>Detyrimet</b>	<b>0</b>
<b>PASURI NETO</b>	<b>17.326</b>
<b>SHPENZIME</b>	<b>864.000</b>
Shpenzime jetese, sipas ILDKPKI 2005	600.000
Shpenzime për qira apartamenti	144.000
Pajisje elektro-shtëpiake	120.000
<b>DIFERENCA</b>	<b>- 120.170</b>

Në këtë vit, subjekti ka deklaruar të ardhura nga paga e bashkëshortes në shumën 119.000 lekë, për të cilën nuk disponojnë dokument nga punëdhënësi. Nga korrespondenca me Drejtorinë Arsimore Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.06.2018, vërtetohet se dokumentet për mësuesit që kanë punuar (*në dispozicion*) për periudhën 1994 - 2010 janë dorëzuar në Arkivin e Sigurimeve në Lundër.

Subjekti ka paraqitur në Komision kopje të librezës së punës së bashkëshortes, ku vërtetohet se znj. E. Q. M, në periudhën 20.01.2003 deri më 26.12.2003, ka punuar (*në dispozicion*) në Qendrën Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve. Pavarësisht se nuk ekziston e dokumentuar pagesa e personit të lidhur me subjektin/ znj. E. M, duke marrë në konsideratë pagën minimale për vitin 2003, e cila shkon në shumën 10.060 lekë, raporti të ardhura - shpenzime për vitin 2003 konsiderohet në balancë.

**Në vitin 2004, një rezultat financiar me balancë negative prej 106.017 lekësh, sipas tabelës së përlllogaritjeve si më poshtë:**

*Viti 2004*

PËRSHKRIMI	2004
<b>Të ardhurat e dokumentuara</b>	<b>806.657</b>

Paga e subjektit	806.657
<b>PASURI</b>	<b>-17.326</b>
Gjendje në bankë	-17.326
<b>Detyrimet</b>	<b>0</b>
<b>PASURI NETO</b>	<b>17.326</b>
<b>SHPENZIME</b>	<b>930.000</b>
Shpenzime jetese	600.000
Shp. qira apartamenti	200.000
Blerje pajisje elektro-shtëpiake	130.000
<b>DIFERENCA</b>	<b>-106.017</b>

Në vitin 2004, subjekti deklaroi në pyetësor shpenzime për qira banese për të jetuar familjarisht në shumën 200.000 lekë, të cilat u morën në konsiderate në analizën financiare.

**Në vitin 2005, një rezultat financiar me balancë negative prej 199.945 lekësh, sipas tabelës së përlllogaritjeve si më poshtë:**

#### Viti 2005

PËRSHKRIMI	2005
<b>Të ardhurat e dokumentuara</b>	<b>787 398</b>
Paga e subjektit	787 398
<b>PASURI</b>	<b>187 343</b>
Likuiditete <i>cash</i>	200 000
Gjendje në bankë	-12 657
<b>Detyrimet</b>	<b>0</b>
<b>PASURI NETO</b>	<b>187 343</b>
<b>SHPENZIME</b>	<b>800 000</b>
Shpenzime jetese, sipas ILDKPKI	600 000
Shpenzime për qira apartamenti	200 000
<b>DIFERENCA</b>	<b>- 199 945</b>

**Të ardhurat vjetore nga paga neto e subjektit të rivlerësimit nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet për jetesë të llogaritura si minimum jetik nga ILDKPKI-ja, për të paguar qiranë e apartamentit dhe për të arritur të kursejë 200.000 lekë *cash* në fund të vitit 2005.**

Në përfundim, duke marrë në konsideratë shpjegimet e dhëna nga subjekti (të pasqyruara me detaje në pikën 3 të vlerësimit të pasurisë) për ndjekjen e një regjimi të rreptë financiar, si dhe ndihmat materiale të dhëna gjatë kësaj periudhe nga vjehri dhe vëllai i tij, balanca financiare negative për vitet 2004, 2005, por edhe për vitin 2006, rezulton të jetë e papërfillshme dhe nuk mund të arrihet në konkluzionin që kemi të bëjmë me shkelje ligjore që mund të çojnë deri në shkarkimin e subjektit nga detyra.

**Rezultati përfundimtar në lidhje me vlerësimin e pasurisë**

Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me rivlerësimin e pasurisë ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit:

- ✓ Ka pasaktësi të vogla në plotësimin e deklaratave të pasurisë ndër vite; ka burime financiare të ligjshme, balancat financiare negative ndër vite janë të papërfillshme në lidhje me intensitetin e të ardhurave dhe të shpenzimeve të kryera; nuk ka kryer fshehje pasurie; nuk ka kryer deklarim të rremë dhe nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

*Bazuar në sa më lart, në përfundim të procesit të rivlerësimit për kriterin e pasurisë, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Muçi, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa "a", të ligjit nr. 84/2016.*

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

### **Mbledhja e informacioneve dhe provave mbi pastërtinë e figurës**

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke dërguar raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konkluduar mbi "Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Muçi". Ky raport është deklasifikuar<sup>24</sup> në datën 30.01.2018.

Për vlerësimin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Muçi, është kryer një proces i mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi<sup>25</sup>, duke bërë disa verifikime mbi pastërtinë e figurës, duke hetuar mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta, mbi përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në kontakte me persona të papërshtatshëm (anëtarë të organizatave kriminale, persona të dënuar penalisht apo persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale).

### **Rezultati përfundimtar për vlerësimin e kontrollit të figurës**

Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

*Për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është në kushtet e përshtatshme për vazhdimin e detyrës si prokuror.*

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit u bazua në gjetjet dhe pas një analize të plotë në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, ligjin nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe kreun II të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit, duke rishikuar tri dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura

<sup>24</sup>Vendimi nr. \*\*\*, datë 30.01.2018.

<sup>25</sup>Shkresa e DSIK nr. \*\*\* prot., datë 16.07.2018 "Sekret".

sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe me shkresën me nr. \*\*\*, datë 26.12.2017, ka përcjellë pranë Komisionit “Raport për vlerësimin e aftësisë profesionale”<sup>26</sup> të subjektit të rivlerësimit Besnik Muçi për periudhën 08.10.2013 deri më 08.10.2016.

- i) **Raporti për analizën e aftësive profesionale të subjektit, i kryer nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, u është referuar kritereve të rivlerësimit, si:**
- a) Aftësitë profesionale
  - b) Aftësitë organizative
  - c) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale dhe
  - d) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

dhe është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- 1) Formularit të vetëdeklarimit, 3 (tri) dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumentet e tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 2) 5 (pesë) dosje penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) Të dhënat nga burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.

Nga kjo analizë konstatohet:

### **1. Aftësitë profesionale**

- a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Muçi, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në përgjithësi analizon normën penale të zbatueshme, në raport me faktet dhe provat.

- b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Muçi, ka aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet, kërkesat dhe aktet e tjera të përpiluar prej tij janë të qarta dhe të kuptueshme. Përgjithësisht, përmbajtja e akteve u jep përgjigje çështjeve të ngritura në hetim.

### **2. Aftësitë organizative**

- a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti rivlerësimit, z. Besnik Muçi, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016 ka kryer detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Në dosjet e vëzhguara evidentohet aftësia për të organizuar punën dhe respektuar afatet hetimore të përcaktuara në ligj, për të arritur në zgjidhjen përfundimtare.

- b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Konstatohet që nga ana e subjektit të rivlerësimit veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzimore u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat dhe aktet e nevojshme e duke arritur në vendimmarrje objektive.

- c) Aftësia për të administruar dosjet

---

<sup>26</sup>Shiko për më tepër shkresën me nr. \*\*\*, datë 12.01.2018, ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme, e cila ndodhet në dosje të Komisionit.

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve hetimore të përzgjedhura me short janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të (*vendimet për zgjatjen e afateve hetimore në procedimin penal nr. 90/1, viti 2014*). Në 5 dosjet e vëzhguara, mangësitë janë pothuajse të njëjta: renditja e akteve paraqet parregullsi, në disa akte mungojnë nënshkrimet. Sa i përket në tërësi aftësisë për të administruar dosjet, nuk u konstatuan problematika të tjera.

### **3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

#### **a) Etika në punë**

Në vlerësimin e respektimit të disiplinës në punë, nga ana e prokurorit është përmbushur me besnikëri disiplina dhe të gjitha angazhimet profesionale, personale, morale dhe etike në ushtrimin e funksioneve të tij, në zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, duke ruajtur të pastër figurën e prokurorit.

#### **b) Integriteti**

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Muçi, dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Prokurori Besnik Muçi, gjatë periudhës së rivlerësimit nuk ka pasur masa disiplinore.

#### **c) Paanësia**

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara, nuk ka të dhëna që të jetë kërkuar përjashtimi i tij nga hetimi i çështjeve apo nga përfaqësimi në gjykim i tyre. Duke përjashtuar mangësitë e evidentuara tek aftësitë organizative, në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Muçi, të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

### **4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

#### **a) Aftësitë e komunikimit**

Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka të dhëna të plota për mënyrën e komunikimit të subjektit Besnik Muçi me palët e tjera në proces dhe me gjykatën. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

Komunikimi, bashkëpunimi, sjellja ndaj eprorëve, kolegëve, vartësve dhe administratës, ka qenë korrekte, duke respektuar dinjitetin dhe personalitetin e tyre.

#### **b) Aftësia për të bashkëpunuar**

Subjekti ka cilësi të mira bashkëpunuese, si dhe është i gatshëm të punojë në grup dhe me agjenci të tjera ligjzbatuese. Është i hapur për diskutim dhe ndarje të përvojës me kolegët.

#### **c) Gatishmëria për t'u angazhuar**

Subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Muçi, ka marrë titullin "Jurist" në vitin 1995 në Universitetin e Tiranës, ka përfunduar masterin në Shkenca Penale në vitin 2012 dhe është në ndjekje të procesit të doktoraturës, profili penal, po në këtë universitet. Subjekti i është nënshtruar programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe ka paraqitur dokumentet që vërtetojnë pjesëmarrjen në këto aktivitete. Gjithashtu, në periudhën e rivlerësimit, ai deklaroi

se është angazhuar në 16 aktivitete profesionale (*seminare, trajnime specifike, konferenca, workshop-e*). Në këtë kuptim, prokurori Besnik Muçi ka shprehur vazhdimisht gatishmëri për t'u angazhuar në veprimtaritë trajnuese.

**ii) Përshkrimi i 5 dosjeve penale për prokurorin Besnik Muçi, të përzgjedhura me short**

Pesë dokumentet ligjore të përzgjedhura me short u vunë në dispozicion nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, më datë 22.11.2017. Me paraqitjen e tyre, u procedua menjëherë me vëzhgimin e tyre dhe analizën e të dhënave të nxjerra nga vëzhgimi. Kopjet e këtyre 5 dosjeve në formatin letër janë përfshirë në dosjen e vlerësimit të subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Muçi. Gjetjet nga vëzhgimi i këtyre 5 dosjeve përshkruhen më poshtë.

**1. Material për hetimin pasuror, nr. s'ka, datë regjistrimi 13.09.2011. Vendim mosfillimi, datë 06.01.2014. Verifikimi pasuror është kryer për shtetasin E. K, i cili është proceduar penalisht nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.**

Nga aktet rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka regjistruar procedimin penal nr. 953, datë 13.09.2011, në ngarkim të të pandehurit E. K, i akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 283/1 e 285 të Kodit Penal. Më datë 12.09.2011, i pandehuri E. K është kapur në flagrancë nga punonjësit e Drejtorisë së Policisë Elbasan, pasi mbante me vete një sasi lënde narkotike prej 12 gr, të llojit heroinë, të ndarë në dy pjesë.

Veprimet hetimore: Prokurori Besnik Muçi ka shtrirë hetimin pasuror, duke kërkuar informacion mbi gjendjen pasurore të shtetasit E. K dhe personave të lidhur me të sipas të dhënave të marra nga Zyra e Gjendjes Civile. Informacion u është kërkuar: Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor, bankave të nivelit të dytë, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Qendrës Kombëtare të Licencave, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t.

Më datë 06.01.2014, prokurori ka marrë vendim për mosfillimin e procedimit pasuror. Aktet paraqiten të plota, por vërehen parregullsi në mënyrën e administrimit të tyre, pasi në disa raste konstatohet që renditja e tyre nuk është kronologjike dhe përgjigjet nga institucionet nuk ndjekin radhën e shkresave të dërguara atyre nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

**Hetimi i kryer nga Komisioni dhe arsyetimi ligjor**

Nga verifikimi i fashikullit të këtij procedimi, rezulton se nuk ndodhen në dosje:

- ✓ Miratimi i drejtuesit të Prokurorisë për vendimin e subjektit për ‘Mosfillimin e procedimin pasuror’.
- ✓ Njoftimi i vendimit për “Mosfillimin e procedimit pasuror”, më datë 06.01.2014, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan në kuadrin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2011, të Prokurorisë Elbasan në ngarkim të shtetasit E. K, veprim që bie në kundërshtim me nenin 291/2 të Kodi i Procedurës Penale, në fuqi në kohën e marrjes së vendimit nga subjekti i rivlerësimit, viti 2014, ku citohet se: “*Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, viktimës ose trashëgimtarëve të saj, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit*”.

Subjekti, në shpjegimet e tij dërguar pranë Komisionit me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.07.2018, sqaron se: *“Lidhur me verifikimin pasuror të kryer për shtetasin E. K, për të cilin kam vendosur më datë 06.01.2014 mosfillimin e procedimit pasuror, më lejoni t’ju bëj me dije se miratimi i drejtuesit të Prokurorisë në atë periudhë bëhej duke firmosur kalimin në arkiv të fashikullit të dosjes së mosfillimit. Konstatimi i mosnjoftimit të Prokurorisë Elbasan është i drejtë, por është vlerësuar se jemi brenda të njëjtit institucion.”*

Në këndvështrim të nenit “E” të Aneksit të Kushtetutës, neneve 73 - 76 dhe 78 të ligjit nr. 96/2016, si dhe nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, pavarësisht të metave të evidentaura më sipër, konstatohet se ato nuk kanë lidhje me hetimin e kryer e për rrjedhje nuk përbëjnë shkak deri në atë masë sa të konkludohet për paaftësi profesionale të subjektit për rastin konkret.

**2. Procedimi pasuror nr. \*\*\*, datë regjistrimi 14.04.2014. Kërkesë për konfiskim në datë 14.10.2014. Verifikimi pasuror është kryer për shtetasin K. N, i cili është proceduar penalisht nga Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë në kuadër të procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2011, për kryerjen e veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.**

Nga aktet rezulton se Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. 06, të vitit 2011, në ngarkim të shtetasve A. M etj., për veprën penale të “Trafikimit të narkotikëve” dhe ndaj shtetasit K. N për veprën penale të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. Më datë 13.02.2011, shtetasi K. N i ka shitur shtetasit A. T një sasi prej 100.08 kg lëndë narkotike të llojit kanabis sativa, kurse më datë 09.05.2011 i është sekuestruar një sasi tjetër nga kjo lëndë prej 4.124 kg.

K. N është akuzuar dhe marrë i pandehur për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal dhe çështja në ngarkim të tij është dërguar për gjykim.

Në momentin e arrestimit, shtetasit K. N i janë sekuestruar 21.700 euro dhe 22.200 lekë. Në hetim është vërtetuar se ky shtetas disponon dhe pasurinë e llojit arë me nr. \*\*\*, ZK. \*\*\*, \*\*\*, Shkodër, e regjistruar më datë 08.04.2002. Nga verifikimet e tjera të kryera për këtë shtetas, ka rezultuar se ai nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për të justifikuar shumën prej 21.700 eurosh, që i janë sekuestruar në momentin e arrestimit në flagrancë.

Duke qenë se vepra penale e parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal hyn në kategorinë e atyre të parashikuara nga neni 3/1 i ligjit nr. 10192/2009, prokurori Besnik Muçi ka disponuar për regjistrimin e procedimit pasuror për shtetasin K. N, sipas vendimit datë 14.04.2014. Ky vendim është bazuar në relacionin e datës 05.12.2011 “Për kalimin e akteve seksionit për hetimin pasuror” të prokurores që ka pasur për hetim procedimin penal nr. \*\*\* të vitit 2011. Relacionit i janë bashkëngjitur kopje të akteve të procedimit penal nr. \*\*\*:si: urdhër për regjistrimin e procedimit penal dhe për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, vendimi për njoftimin e akuzës, vendimi për dërgimin e çështjes për gjykim, akte nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, që kanë të bëjnë me deklarimin fajtor të shtetasit K. N nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. Nga subjekti është kryer e gjithë korrespondenca e duhur me qëllim evidentimin e aseteve në emër të shtetasit Kol Nika.

Në fashikull gjendet praktika e ekzekutimit të vendimit nr. \*\*\*, datë 17.04.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë me objekt “Sekuestrimin e pasurive të shtetasit K. N”. Ky vendim është dhënë në vijim të kërkesës me të njëjtin objekt të paraqitur para kësaj gjykate nga Prokuroria për Krime të Rënda, e përfaqësuar nga prokurori Besnik Muçi. Është



kërkuar sekuestrimi i pasurive të shtetasit K. N, konkretisht të shumave 21.700 euro dhe 22.200 lekë, si dhe të automjetit tip “Benz”, me targë \*\*\*.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë e ka pranuar kërkesën e prokurorit, duke vendosur sekuestron mbi pasuritë e sipërcituara. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.05.2014, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

Më datë 11.11.2014, prokurori Besnik Muçi ka paraqitur para Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë kërkesën me objekt “Konfiskimin e pasurive të shtetasit K. N”, bazuar në nenet 21, 23, 24 të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009. Në kërkesë janë parashtruar rrethanat e faktit në këndvështrim të parashikimeve të ligjit nr. 10192/2009.

Në fashikull gjendet i administruar akti i datës 23.02.2015 që përmban bisedimet përfundimtare të prokurorit Besnik Muçi në seancën gjyqësore të zhvilluar. Në këtë akt, prokurori analizon rrethanat e faktit, provat ndaj të paditurit, sendet që ka në pronësi, të cilat nuk është në gjendje t'i justifikojë, provat e thirrura nga gjykata, si ato me dëshmitarë, etj. Ka analizuar problemet e këtyre provave, mangësitë në procesin e të provuarit, faktin që dëshmitë nuk mbështeten në prova shkresore si dhe kërkimet përfundimtare që vijnë në përputhje me kërkesën fillestare të prokurorit.

Me vendimin nr. \*\*\*, datë 03.03.2015, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vendosur rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë me objekt “Konfiskimin e shumës prej 21.700 eurosh dhe 22.200 lekësh dhe automjetin tip “Benz” me targë \*\*\*”.

Kundër këtij vendimi ka ushtruar të drejtën e ankimit prokurori Besnik Muçi, me aktin e ankimit datë 11.03.2015, drejtuar Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda e ka gjetur të drejtë ankimin e bërë nga prokurori Besnik Muçi dhe me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.04.2015, ka vendosur të ndryshojë vendimin nr. \*\*\*, datë 03.03.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe konfiskimin e pasurive, automjetin tip “Benz” me targë \*\*\* dhe shumave monetare 21.700 euro dhe 22.200 lekë. Kundër këtij vendimi ka bërë rekurs mbrojtësi i të paditurit me aktin përkatës të datës 27.04.2015 drejtuar Gjykatës së Lartë. Pas shqyrtimit në dhomë këshillimi, Gjykata e Lartë me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.06.2015, ka vendosur mospranimin e rekursit.

Veprimet hetimore: Prokurori Besnik Muçi, në vijim të relacionit të paraqitur nga prokurorja e ngarkuar me hetimin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2011 më datë 05.12.2011, ka marrë vendimin datë 14.04.2014 për regjistrimin e procedimit pasuror nr. \*\*\* me subjekt shtetasin K. N. I ka kërkuar në mënyrë verbale Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër praktikën në lidhje me hetimin dhe gjykimin e të pandehurit K. N, praktikë e cila është dërguar nga kjo Prokurori në Prokurorinë për Krime të Rënda Tiranë. Veprime të tjera hetimore nuk janë kryer, përveç administrimit të akteve bashkëngjitur relacionit datë 05.12.2011 dhe shkresës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Pas regjistrimit të procedimit pasuror më datë 14.04.2014, prokurori Besnik Muçi ka paraqitur kërkesë në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda me objekt sekuestrimin e pasurive, kërkesë për plotësimin e vendimit për sekuestrimin e pasurive, ku është përcaktuar vendndodhja e këtyre pasurive.

Në fashikull gjendet dhe praktika që i përket fazës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar ka të metë faktin se urdhri i regjistrimit të procedimit pasuror nuk përmban nënshkrimin e prokurorit që e ka përpiluar atë. Aktet paraqiten të plota. Pas këtij inventari gjenden fletë të tjera të lidhura në fashikull, por që nuk janë të numëruara

dhe që u përkasin akteve pas paraqitjes së kërkesës me objekt konfiskimin e pasurisë, si vendime gjyqësore, ankim prokurori, konkluzionet përfundimtare në gjykimin në shkallë të parë, vendimi i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe rekursi i avokatit të të paditurit dhe aktet bashkëngjitur këtij rekursi.

Kërkesa e prokurorit për konfiskimin e pasurisë, diskutimi përfundimtar dhe akti i ankimit në gjykatën e shkallës së dytë përmbajnë formën dhe strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural.

Nga pikëpamja e strukturës, aktet janë ndarë në paragrafë, janë respektuar përgjithësisht mirë rregullat e drejtshkrimit, fjalitë ndonjëherë paraqiten të gjata, por përmbajnë referenca ligjore. Teksti paraqitet i qartë dhe i kuptueshëm.

Përmenden në arsyetim norma të Kodit Penal, të Kodit të Procedurës Penale, të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr. 10192/2009.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni dhe arsyetimi ligjor**

Pas verifikimit të dokumentacionit të ndodhur në këtë fashikull, Komisioni konkludon se nga ana e subjektit janë kryer veprimet e duhura hetimore, duke u kryer një proces hetimor i thelluar dhe i plotë. Këtë fakt e vërteton më së miri edhe vendimmarrja përfundimtare e gjykatës që ka pranuar çdo kërkim të prokurorit z. Besnik Muçi.

Bazuar në nenin “E” të Aneksit të Kushtetutës, nenet 73 - 76 dhe 78 të ligjit nr. 96/2016, si dhe nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, pavarësisht ndonjë të metë të karakterit material, nuk rezultojnë indice apo prova për paaftësi profesionale të subjektit për rastin konkret.

### **3. Procedimi penal nr. \*\*\*, datë 06.10.2015, që bën fjalë për veprën penale të “Shtërngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie pasurie”, parashikuar nga neni 109/b i Kodit Penal. Procedimi penal është pushuar me vendimin e datës 19.09.2016.**

Ky procedim penal është regjistruar mbi bazën e kallëzimit nr. \*\*\*, datë 13.07.2015, informacion i DPPSH-së.

Sipas informacionit, shtetasi V. Gj është ndaluar si i dyshuar për vrasjen e shtetasit H. K, ndërtues. Dyshimi është krijuar pasi në vitin 2007 vëllai i të dyshuarit, F. Gj, dhe kushëriri i tij, S. Gj, kanë porositur apartamente në objektin e viktimës, duke paguar si paradhënie dhe një shumë prej 85.000 eurosh. Po këtë vit janë pezulluar punimet dhe kanë rifilluar në vitin 2012. Në këtë vit, dy porositësve u është kthyer shuma e paguar dhe është prishur dhe kontrata. Që nga ky moment, dy personat kanë filluar të ndërmarrin veprime ndaj dy bashkëpronarëve, H. K dhe E. S, shoqëruar me ndalime të personave, kërcënime etj. Edhe pasi është vrarë H., ata kanë vazhduar kërcënimet ndaj bashkëshortes së tij, M. K, së cilës i kanë kërkuar tri apartamente e tre garazhe, në të kundërt do t’i vrisnin fëmijët. Nën këtë presion është bërë shitja fiktive e pronave si më sipër në emër të tre personave të tjerë, I. K, M. Sh e E. R.

Sa më sipër janë krijuar dyshime të arsyeshme se nga ana e shtetasve Gj. janë konsumuar elemente të veprës penale “Shtërngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie pasurie”, parashikuar nga neni 109/b i Kodit Penal.

Veprimet hetimore: Pas informacionit (pa datë) të oficerit të Policisë Gjyqësore për kryerjen e veprimeve verifikuese, është vendosur regjistrimi i procedimit penal (*vendim datë 06.10.2015*). Prokurori ka përpiluar urdhrin datë 14.07.2015 për kryerjen e veprimeve hetimore nga oficeri

i Policisë Gjyqësore. Është kërkuar informacion nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë në lidhje me shtetasin H. K, vlarë më datë 05.05.2013, në Rr. “\*\*\*”, Tiranë, me shkresën nr. \*\*\*, datë 21.10.2015. Prokurorisë i është kthyer përgjigje nga kjo drejtori me shkresën nr. 20659/1-K, datë 14.12.2015. Nga faqja 28 deri në faqen 125 të fashikullit (*fotokopje*) janë administruar kopje kontratash dhe të dhëna nga sistemi TIMS, por nuk ka akte procedurale për mënyrën e administrimit e si rrjedhim nuk mund të përcaktohet data e kryerjes së veprimeve dhe as personat nga të cilët janë marrë këto dokumente. Janë përpiluar tre urdhra për thirrjen e shtetasve, datë 25.08.2015. Gjendet shkresa nr. \*\*\*, datë 27.10.2015, shoqëruar me urdhër për thirrjen e shtetasit, drejtuar Komisarariatit të Policisë nr. 1 Tiranë. Në dosje janë administruar gjithashtu procesverbale deklarimi të shtetasve të datave 07.08.2015, 10.08.2015, 26.08.2015, 27.08.2015, 02.09.2015, 03.09.2015, 04.09.2015, 08.09.2015, 10.09.2015, 21.10.2015, 10.12.2015. Në fashikull gjenden dhe urdhri i prokurorit datë 06.10.2015 “Për delegimin e veprimeve hetimore”, relacion për mënyrën e përfundimit të hetimeve i oficerit të Policisë Gjyqësore, pa datë.

Për këtë procedim nuk ka zgjatje afati, pasi nuk ka të regjistruar emër të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime.

Nuk ka njoftim akuzë e as masë sigurimi.

Në përfundim të hetimeve paraprake, prokurori Besnik Muçi ka disponuar me vendim për pushimin e hetimeve datë 19.09.2016, bazuar në nenet 224/2 e 328/1, germa “dh” të Kodit të Procedurës Penale.

**Konstatim i Grupit të Punës të Prokurorisë së Përgjithshme (PP):**

Baza ligjore nuk është plotësisht e saktë, sa i përket nenit 224/2 të Kodit të Procedurës Penale, pasi kjo dispozitë ka të bëjë me mënyrën e disponimit të materialeve të përgjimeve në rastet e pushimit të çështjes dhe në këtë procedim nuk janë kryer veprimet hetimore të përgjimit.

Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar ka disa të meta. Mungojnë aktet procedurale për administrimin e kontratave dhe të dhënave nga sistemi TIMS. Mungon data në relacionin përfundimtar të oficerit të Policisë Gjyqësore.

Nuk ka arsyetim mbi dispozitën ligjore të Kodit Penal në raport me të dhënat.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

Përveç konstatimeve të Grupit të Punës së Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton se për këtë çështje penale: Nuk është kryer hetim i thelluar nga ana e subjektit të rivlerësimit, pasi është marrë vendim për pushimin e çështjes penale, më datë 19.09.2016, nga subjekti vetëm bazuar në deklaratat që u morën shtetasve që kishin dijeni për çështjen; nuk janë ndërmarre procedura ligjore për të evidentuar numrat telefonikë që kanë pasur personat e thirrur për të dhënë shpjegime dhe deklarata, para dhënies së deklarimeve para prokurorit, si edhe pas dhënies së shpjegimeve; nuk janë nxjerrë dhe nuk janë analizuar tabulatet e numrave respektivë; nuk është thirrur për të dhënë shpjegime z. F. F; nuk ka kryer hetim në lidhje me burimin e të ardhurave të personave që kanë blerë pasuritë e paluajtshme. Ky veprim vjen në kundërshtim me nenin 304 të Kodit të Procedurës Penale, i cili thotë: “*Prokurori drejton veprimtarinë hetimore dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm. Ai kryen hetime edhe për verifikimin e fakteve ose rrethanave në favor të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime*”.

Nuk ndodhet në dosje njoftimi i vendimit “Për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2015” i subjektit të rivlerësimit, veprim që bie në kundërshtim me nenin 291/2 të Kodit të Procedurës Penale, në fuqi në kohën e marrjes së vendimit nga subjekti i rivlerësimit, viti 2015, ku citohet se :”*Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim,*

viktimës ose trashëgimtarëve të saj, të cilët kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit”, në rastin tonë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Subjekti në shpjegimet e veta ka argumentuar se: “Lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*, datë 06.10.2015, për veprën penale të “Shtrëngimit me anën e kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, parashikuar nga neni 109/b i Kodit Penal dhe për të cilin është vendosur pushimi më datë 19.09.2016, më lejoni t’ju bëj me dije se vendosja edhe e nenit 224/2 të Kodit të Procedurës Penale si bazë për pushimin, është lapsus.

Lidhur me të metën e konstatuar se mungojnë aktet procedurale për administrimin e kontratave dhe të dhënave të sistemit TIMS në dosje, ju bëj me dije se këto akte janë dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit së bashku me informacionin e dërguar prej saj me shkresën nr. \*\*\*, datë 13.07.2015. Mbi këtë informacion, prokuroria si fillim vendosi regjistrimin e kallëzimit penal nr. \*\*\*, datë 13.07.2015, dhe pas verifikimeve të kryera prej saj, regjistrimin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2015. Në faqen 3 të këtij informacioni pasqyrohet një fakt i tillë. Vlerësoj se nga ana e prokurorisë dhe Policisë Gjyqësore janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme dhe të domosdoshme me qëllim zgjidhjen përfundimtare dhe ligjore të çështjes penale.

Po ashtu, vlerësoj se në çdo procedim penal të pushuar ka vend gjithnjë për kryerjen e veprimeve të tjera hetimore, përfshi edhe këtë procedim. Në këtë procedim, nga ana ime, janë drejtuar dhe kontrolluar veprimet hetimore si fillim nëpërmjet urdhrit për kryerjen e veprimeve hetimore me qëllim verifikimin e kallëzimit të regjistruar mbi bazën e informacionit të policisë. Më pas, me administrimin dhe analizimin e informacionit të oficerit të Policisë Gjyqësore, z. A. V, vendosa regjistrimin e procedimit penal dhe urdhërova kryerjen e një sërë veprimesh hetimore, me qëllim sqarimin e plotë të rrethanave të faktit dhe përcaktimin e përgjegjësisë penale. Oficerët e Policisë Gjyqësore që janë marrë me hetimin e çështjes kanë qenë të ngarkuar dhe kanë pasur të drejtë të kryenin të gjitha verifikimet e nevojshme, përfshi edhe ato pasurore. Nga ana ime mund të ishte ushtruar kontroll më i mirë ose të ishin ndërmarrë veprime vetë.

Për veprimet hetimore të marrjes së tabulateve telefonike dhe analizës së tyre, vlerësoj se nuk do të sillnin të dhëna ose prova të reja për procedimin pasi fakti kriminal i dyshuar ishte kryer rreth 2 vjet para se të referohej informacioni nga policia dhe se personat e pyetur gjatë hetimit, i kanë pranuar kontaktet dhe takimet midis tyre. Në këtë procedim duhet të vlerësojmë dy fakte: “së pari, që personi i dëmtuar nuk e pranonte që ishte shtrënguar për të kryer kalimin e pronësisë; dhe, së dyti, kalimi i pronësisë është bërë formalisht nëpërmjet veprimit noterial.

Lidhur me njoftimet për pushimin e hetimeve është njoftuar shtetasi Sh. K. Konstatimi i mosnjoftimit të Policisë së Shtetit është i drejtë, por është vlerësuar se hetimet janë kryer nga oficeri i Policisë Gjyqësore i Policisë së Shtetit pranë Prokurorisë për Krime të Rënda”.

#### ❖ **Arsyetimi ligjor**

Pas verifikimit të dokumentacionit të ndodhur në këtë fashikull, Komisioni konkludon se nga ana e subjektit nuk është kryer një proces hetimor i thelluar dhe i plotë.

Në këndvështrim të kërkesave të nenit “Ë” të Aneksit të Kushtetutës, të nenit 78, pika 5, të ligjit nr. 96/2016 dhe të neneve 44/b dhe 44/c të ligjit nr. 84/2016, të metat dhe mangësitë e konstatuara nga Komisioni në hetimin e kryer nga subjekti nuk janë në nivelin e kërkesave që do të çonin në një vendimmarrje të Komisionit për shkarkim nga detyra në përputhje me nenin

61/4 të ligjit nr. 84/2016. Për rastin konkret, subjekti arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

**4. Procedimi penal nr. \*\*\*, datë 20.08.2013, që bën fjalë për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve”, mbetur në tentativë, të parashikuar nga neni 283/a në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal. Procedimi penal është dërguar për gjykim me vendimin datë 15.04.2014.**

Ky procedim penal është regjistruar në vijim të urdhrin datë 20.08.2013, me të cilin është disponuar dhe për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, duke pasur për bazë aktet e referimit të veprës penale nga shërbimet e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Gjirokastrë, të datës 19.08.2013.

Në vijën e dytë të kontrollit është kryer kapja në flagrancë e shtetasit T. B, me një sasi lënde të dyshuar narkotike e llojit marijuanë, në momentin që ky i fundit ishte nisur të kalonte kufirin shtetëror për në Greqi. Lënda është gjetur e fshehur brenda në prapakolpin e mjetit, e paketuar në formë kuboidi dhe e mbështjellë me natriban me ngjyrë të gjelbër, gjithsej 28 pako. Pasi u peshuan, rezultoi që pesha totale e tyre të ishte 8995,4 gramë.

Veprimet hetimore: Në fazën e hetimeve paraprake për këtë çështje penale janë administruar: tabela fotografike e këqyrjes së automjetit më datë 20.09.2013; Është marrë vendim për kryerjen e ekspertimit teknik kompjuterik, më datë 08.12.2014 (*duhet të jetë viti 2013*) dhe administruar aktet e ekspertimit, nr. \*\*\*, datë 20.01.2014; nr. \*\*\*, datë 11.03.2014. Janë kërkuar të dhëna nga shoqëritë celulare, është marrë vendim për këqyrje e marrje të dhënash nga sistemi TIMS, etj.. Është përpiluar nga prokurori kërkesa për vlerësimin e arrestit në flagrancë e caktimin e masës së sigurimit për shtetasin T. B dhe çështja është dërguar në gjykatë.

Prokurori ka kërkuar në diskutimin përfundimtar deklarimin fajtor të të pandehurit T. B për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/1 dhe 22 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 8 vjet burgim. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë e ka deklaruar këtë të pandehur fajtor për këtë vepër penale me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.06.2014, dhe e ka dënuar me të njëjtën masë dënimi të kërkuar nga prokurori.

Kundër vendimit gjyqësor është ushtruar apel dhe rekurs nga avokati mbrojtës i të pandehurit T. B. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. \*\*\*, datë 09.10.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Në bazë të rekursit të avokatit të të pandehurit, Gjykata e Lartë, në dhomë këshillimi, me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.12.2015, ka vendosur mospranimin e rekursit.

Baza ligjore sa i përket kërkesës për gjykim është e saktë, nenet 331, 332 të Kodit të Procedurës Penale.

Përmenden në kërkesë baza ligjore nga Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni dhe arsyetimi ligjor**

Pas verifikimit të dokumentacionit, Komisioni konkludon se nga ana e subjektit janë kryer veprimet e duhura hetimore, duke u kryer një proces hetimor i thelluar dhe i plotë. Këtë fakt e vërteton më së miri edhe vendimmarrja përfundimtare e gjykatës, që ka pranuar çdo kërkim të prokurorit, z. Besnik Muçi.

Bazuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës, nenet 73 - 76 dhe 78 të ligjit nr. 96/2016, si dhe nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, nuk rezultojnë indice apo prova për paaftësi profesionale të subjektit për rastin konkret.

**5. Procedimi penal nr. \*\*\*, datë 10.04.2015, që bën fjalë për veprën penale të “Trafikimit të narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal. Procedimi penal është pushuar me vendimin e datës 30.12.2015.**

Prokuroria për Krime të Rënda ka regjistruar më datë 17.03.2014 procedimin penal nr. \*\*\* për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal. Procedimi është nisur mbi bazën e akteve të sjella me shkresën nr. \*\*\*, datë 17.03.2014, të departamentit kundër krimit të organizuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Nga aktet bashkëngjitur shkresës rezulton se shtetasi F. D, në bashkëpunim me persona të tjerë, zhvillojnë aktivitet kriminal në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike kanabis sativa. Me urdhrin e datës 11.04.2014, prokurori ka disponuar për regjistrimin e emrave të shtetasve E. P, G. D, F. D, E. J, N. M, E. K, në cilësinë e personave ndaj të cilëve zhvillohen hetime për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal.

Veprimet hetimore: Në fazën e hetimeve paraprake për këtë çështje penale janë administruar: fashikulli i procedimit penal nr. 90, i vitit 2014 (*kopje të gjitha aktet e këtij procedimi*); aktet e letërporosisë së ardhur nga shteti grek (*në gjuhën greke dhe të përkthyer në shqip*), që u përkasin personave ndaj të cilëve zhvillohen hetime, J. B e E. K, nga të cilat rezulton se këta dy shtetas janë arrestuar e dënuar me vendim të formës së prerë në shtetin grek, për të njëjtin fakt (*pasi operacioni policor është kryer në bashkëpunim nga policitë e dy shteteve*). Sipas letërporosisë, i pandehuri J. B ka kryer dënimin dhe është liruar më datë 21.10.2015 nga burgu i Tiryntas, Greqi, kurse i pandehuri E. K është dënuar me 11 vjet burg dhe vazhdon vuajtjen e dënimit në shtetin grek. Gjithashtu, në fashikull janë administruar aktet e ekzekutimit të masës së sigurimit “arrest në burg” në mungesë, mbi bazë të urdhrin të prokurorit, në momentin e hyrjes në Shqipëri të shtetasit J. B, më datë 24.10.2015. Meqenëse personi ka pasur me vete dokumentet greke të liritimit, pas verifikimit nga Zyra Ndërlidhëse Policore e Ambasadës së Greqisë në Shqipëri, ato kanë rezultuar origjinale dhe mbi këtë bazë janë pushuar hetimet ndaj shtetasit J. B dhe është shuar masa e sigurimit “arrest në burg”, me vendimin datë 09.11.2017. Kurse, pas mbërritjes së letërporosisë dhe konfirmimit që i pandehuri E. K vuan dënimin në shtetin grek, për të njëjtin fakt, më datë 30.12.2015, është vendosur pushimi i hetimeve ndaj tij.

Pas shqyrtimit të akteve të fashikullit hetimor dhe përmbajtjes së vendimit të parë të zgjatjes, vendimi i marrë nga prokurori për këtë qëllim është i justifikuar për arsyet që ka përmendur në të. Për pjesën tjetër të vendimeve është e pamundur të shprehemi, duke qenë se mungojnë të administruar.

Baza ligjore për sa i përket vendimit të pushimit është e saktë, neni 328/1, germa “e”, i Kodit të Procedurës Penale, në referim të neneve 6/2 të Kodit Penal e 7 të Kodit të Procedurës Penale. Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar nuk është i plotë, pasi mungojnë vendimet për zgjatjet e afatit të hetimeve, që i përkasin periudhës pasi është marrë vendimi për ndarjen e procedimit penal nr. 90/2014.

Në vendim janë parashtruar arsyet e ndarjes së procedimit penal dhe veprimet hetimore që kanë qenë të nevojshëm për t’u kryer posaçërisht për shtetasit J. B e E. K. Pas administrimit të akteve procedurale të sjella nga autoritetet gjyqësore greke, janë dhënë arsyet ligjore për pamundësinë e vazhdimin të hetimeve për këta dy shtetas, konkretisht për shkak se rezultoni të dënuar për të njëjtën vepër penale në shtetin grek. Në përfundim të këtij arsyetimi, duke referuar në një bazë të drejtë ligjore, prokurori ka disponuar për pushimin e hetimeve të këtij procedimi penal.

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

- Pas shqyrtimit të akteve të fashikullit hetimor dhe përmbajtjes së vendimit të parë të zgjatjes, vendimi i marrë nga prokurori për këtë qëllim është i justifikuar për arsyet që ka

përmendur në të. Për pjesën tjetër të vendimeve për zgjatjen e afateve mungojnë të administruara vendimet përkatëse.

- Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar nuk është i plotë, pasi mungojnë vendimet për zgjatjet e afatit të hetimeve, që i përkasin periudhës pasi është marrë vendimi për ndarjen e procedimit penal nr. \*\*\*/2014.
- Në të dyja vendimet e pushimit, prokurori është shprehur edhe për shuarjen e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues për personat nën hetim. Në këtë rast, duhej të përmendej si bazë ligjore neni 261/1, germa “a”, i Kodit të Procedurës Penale.
- Neni 261/1 i Kodit të Procedurës Penale citon: “ *Masat e sigurimit shuhen: a) kur për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtit person është vendosur pushimi i çështjes ose është dhënë vendimi i pafajësisë; b) kur dënimi i caktuar shpallet i shuar ose i pezulluar me kusht; c) kur kohëzgjatja e paraburgimit të vuajtur është më e madhe se masa e dënimit të caktuar; ç) kur pas mbarimit të afatit të parashikuar nga shkronja “d”, e paragrafit 1, të nenit 245, të këtij kodi, nuk është urdhëruar përsëritja, brenda kufijve të parashikuar nga nenet 264 dhe 267”.*

Në rastin konkret subjekti nuk citon bazën ligjore, dispozitën përkatëse në vendimin e pushimit.

Subjekti, në shpjegimet e tij, sqaron se: “*Lidhur me procedimin penal nr. 90/1, datë 10.04.2015, për veprën penale të ‘Trafikimit të narkotikëve’ parashikuar nga neni 283/1a/2 i Kodit Penal ju bëj me dije se vendimet për zgjatjen e afateve të hetimit nga data 11.04.2014, kur janë regjistruar në regjistrin e veprave penale emrat e shtetasve J. B dhe E. K në regjistrin e veprave penale në kuadrin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2014, deri në datën 10.04.2015, kur është vendosur ndarja, janë në fashikullin e procedimit penal nr. \*\*\* dërguar për gjykim, rrjedhimisht edhe në fashikullin e arkivit të Prokurorisë së këtij procedimi.*

*Pra, vendimet e zgjatjes së hetimit dhe për shtetasit J. B dhe E. K janë përpiluar nga unë dhe janë njohur personat nën hetim ose mbrojtësit e tyre në kuadrin e hetimeve të procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2014. Fakti që nuk janë në fashikullin e procedimit nr. \*\*\* të vitit 2015, është thjesht një gabim gjatë fotokopjimit nga sekretaria, sepse fashikulli i procedimit \*\*\* i gjithi është pjesë e fashikullit të procedimit \*\*\*. Vetë fakti që në fashikullin e procedimit nr. \*\*\* ndodhet një vendim zgjatjeje afati hetimi i plotë dhe një i dytë i pjesshëm, (ndodhen dy nga tre faqe) provon një gabim të tillë gjatë fotokopjimit.*

*Në vendimet e pushimit për të dy shtetasit nën hetim unë kam argumentuar dhe arsyen e shuarjes së masës së sigurimit “Arrest me burg”. Konstatimi i faktit të mosvendosjes së bazës ligjore për këtë pjesë të vendimit është i drejtë dhe duhet të jetë një mungesë vëmendjeje”.*

### ❖ **Arsyetimi ligjor**

Pas verifikimit të dokumentacionit të ndodhur në këtë fashikull, Komisioni konkludon se nga ana e subjektit janë kryer veprimet e duhura hetimore, duke u kryer një proces hetimor i thelluar dhe i plotë. Kjo vërtetohet edhe nga vendimmarrja përfundimtare e gjykatës, që ka pranuar çdo kërkim të prokurorit Besnik Muci.

Në këndvështrim të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, të neneve 73 - 76 dhe 78 të ligjit nr. 96/2016, si dhe të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, pavarësisht ndonjë të metë të karakterit material, nuk rezultojnë indice apo prova për paaftësi profesionale të subjektit për rastin konkret.

### iii) **Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Muçi, bazuar në ankesat e subjekteve denoncues, si më poshtë:**

#### ***Denoncimi nr. 1.***

**Denoncues:** A. S. G, me adresë: Lagjja “\*\*\*”, Rr. “\*\*\*”, Shkodër; nr. cel: \*\*\*, dosje me nr. \*\*\*prot., datë 30.11.2017.

**Objekti i denoncimit:** “Denoncohet prokurori Besnik Muçi si i paaftë profesionalisht, pasi ngre akuza pa pasur prova reale, lidhur me çështjen e denoncuesit”, bashkëlidhur denoncimi, me shkrim dore (*nuk ka dokumente bashkëlidhur denoncimit*).

Denoncuesi A. G pretendon: Djali im, R. A. B, në cilësinë e anëtarit të grupit kriminal të gjobëvënësve ndaj tregtarëve të lagjes “\*\*\*”, Rr. “\*\*\*”, Shkodër, me anë të një vendimi të prokurorit Besnik Muçi është njoftuar me aktin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 10.07.2017, me akuzën “*Shtrëngim me anë të kanosjes për marrjen e pasurisë*”, “*Krijimit të grupit të strukturuar*”, “*Kryerjes së veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal*”.

Denoncuesi pretendon se djali i tij, R. B, akuzohet pa të drejtë duke i quajtur të pabazuara akuzat e prokurorit në prova konkrete penale, por vetëm në hamendësime, supozime dhe sajesa e deri në dyshime deri në aspektin profesional të personave, konkretisht cilët janë personat që ka shtrënguar apo kërcënuar i biri për t’i marrë pasurinë, etj. Në akuzë, R. G akuzohet në rolin e ndihmësit dhe etiketohet se ka ndihmuar duke u kujdesur që në veprimtarinë kriminale të këtij grupi të mos futej njeri tjetër. Denoncuesi pretendon se prokurori ka paraqitur akuzë të hamendësuar larg realitetit, me punën e tij. Prokurori ka arritur në përfundime të gabuara. Asgjë nuk është provë, pa u ballafaquar me rrethanat e sqarimet e fakteve, citon denoncuesi.

***Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 20.06.2018, ka përcjellë në Komision informacion në lidhje me këtë denoncim kundër subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Muçi, si më poshtë vijon:***

Shtetasi A. S, B(G), banues në Shkodër, nuk rezultoi të ketë paraqitur ankesë në Prokurorinë e Përgjithshme, lidhur me sa pretendon.

Kurse nga verifikimi në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka rezultuar se kjo prokurori, mbi bazën e materialeve të referuara nga Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër, më datë 14.10.2016 ka regjistruar procedimin penal nr. \*\*\*, për veprën penale “*Shtrëngimi me anën e kanosjes për marrjen e pasurisë*”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 109/b e 25 i Kodit Penal, në ngarkim të disa shtetasve, përfshirë edhe R. B.

Në përfundim të hetimeve, nga prokurori i çështjes Besnik Muçi është kërkuar kalimi i procedimit penal për gjykim, në ngarkim të gjithë personave si më sipër, përfshirë edhe të pandehurit R. B, i cili ka qenë në mungesë, duke e akuzuar për veprat penale “*Shtrëngimi me anën e kanosjes për marrjen e pasurisë*”, “*Krijimi i grupit të strukturuar kriminal*” dhe “*Kryerja e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 109/b, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 48/178 regjistri themeltar, datë 26.01.2018, vendosi pezullimin e gjykimit të çështjes në ngarkim të të pandehurit R. B, bazuar në nenin 352, pika 1, të Kodi të Procedurës Penale, për shkak të pamundësisë së njoftimit, duke urdhëruar Policinë Gjyqësore të Komisariatit të Policisë Shkodër të vazhdojnë kërkimet për gjetjen e të pandehurit.

Kurse për të pandehurit M. L, A. B, D.S, B. D, për të cilët është aplikuar procedura e gjykimit të shkurtuar, mbi bazën e kërkesës së tyre, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.04.2018, ka vendosur deklarinimin fajtor dhe dënimin e tyre për veprat penale për të cilat janë akuzuar.

**Hetimi i kryer nga Komisioni dhe arsyetimi ligjor**



Nga verifikimi dhe analiza e kryer nga Komisioni për denoncimin e shtetasit A. S G, informacionit dhe praktikës përkatëse të dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.06.2018, veçanërisht të kërkesës për dërgim në gjyq datë 06.11.2017, të përpiluar nga subjekti i rivlerësimit, prokurori z. Besnik Muçi, si dhe në bazë të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, të neneve 73 - 76 dhe 78 të ligjit nr. 96/2016, si dhe nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, nuk rezultojnë indice apo prova për paaftësi profesionale të subjektit të rivlerësimit për rastin konkret.

### ***Denoncimi nr.2***

**Denocues: M. H. L**, me adresë Rr. “\*\*\*”, pall. “\*\*\*”, kati i 6-të, Tiranë; nr. cel: \*\*\*, me dosjen me nr. denoncimi \*\*\* prot., datë 12.12.2017.

**Objekti i denoncimit:** “Denoncim ndaj prokurorit për korrupsion, sepse ka tjetërsuar akuzën për qëllime përfitimi“, bashkëlidhur dokumentacioni i denoncuesit.

Denoncuesi M. H. L akuzon prokurorin Besnik Muçi, si edhe prokurorin E. K, për tjetërsim të akuzës nga: “*Vrasje e ngelur në tentativë për qëllime hakmarrjeje në bashkëpunim*” në “*Sigurim të kushteve dhe mjeteve për të kryer vrasje në bashkëpunim*”. Denoncuesi thotë se ka dyshime se prokurorët e çështjes janë të korruptuar nga M. T, që është biznesmen minierash hidrocentrale dhe bashkëpunëtori i drejtësisë K. P, i cili ka marrë shumën 50.000 euro për të kryer vrasjen e denoncuesit M. L, fakt që e ka deklaruar edhe para gjykatës.

Bashkëngjitur ndodhet procesverbali i zhvillimit të gjykimit të çështjes në Gjykatën e Shkallës Parë për Krime të Rënda, marrë nga faqja zyrtare e gjykatës. Data e regjistrimit të çështjes është 11.02.2016 me palë ndërgjyqëse: Të pandehur: A. T, K. P, etj. Akuza: “*Vrasje me paramendim në bashkëpunim*”, “*Vrasje me paramendim, në bashkëpunim në tentativë*”, “*Krijim të grupit të strukturuar kriminal*”, “*Kryerja e veprave penale nga grupi i strukturuar*”. Në dosjen e denoncimit ndodhet edhe shkresa me nr. \*\*\*prot., datë 05.08.2018, e Avokatit të Popullit, “Kthim përgjigje”, drejtuar denoncuesit M. L, kur ky i fundit i ishte drejtuar duke u ankuar pasi pretendonte se shtetasit K. P dhe F. M. K kanë dashur ta vrasin me pretendimin me qëllim eliminimin e denoncuesit për shkak se porositësit e vrasësve u kanë zënë padrejtësisht tokën e ligjshme, të cilën denoncuesi e ka fituar me vendim gjyqësor dhe kanë ndërtuar një hidrocentral. Avokati i Popullit informon shtetasin M. L se pas korrespondencës së kryer nga Avokati i Popullit me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, është shpallur moskompetenca dhe aktet i kanë kaluar për hetim të mëtejshëm Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Denoncuesi M. L ka paraqitur kallëzim penal ndaj subjektit të rivlerësimit dhe Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vendosur “*Mosfillimin e procedimit penal më datë 27.09.2017*”.

Sa më sipër, për veç pretendimeve të tij me shkrim, denoncuesi M. L nuk e ka provuar me prova konkrete faktin e korrupsionit të subjektit të rivlerësimit, si dhe faktin që sipas tij subjekti ka ndryshuar akuzën ndaj të pandehurve, të cilët kanë kërkuar vrasjen e tij.

***Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 20.06.2018, ka përcjellë në Komision informacion në lidhje me këtë denoncim kundër subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Muçi, si vijon:***

Ky shtetas, në vazhdimësi, gjatë viteve 2016 – 2017, ka paraqitur ankesa rreth të njëjtit fakt në Prokurorinë e Përgjithshme, por edhe në institucione të tjera, si te Ministria e Drejtësisë,

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Presidenti, Kryeministri, Avokati i Popullit, - të cilët i kanë kaluar për zgjidhje në Prokurorinë e Përgjithshme.

Lidhur me këto ankesa janë kryer verifikimet përkatëse dhe në përfundim është sqaruar ankuesi, me shpjegime të detajuara për bazueshmërinë e akuzës, edhe pse çështja ishte në fazën e gjyqimit, me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 08.04.2016. Megjithatë, ankuesi ka vijuar me ankesa, pasi nuk ka qenë dakord me përgjigjen.

Nga ankesa e datës 27.02.2017 ardhur për dijeni në Prokurorinë e Përgjithshme, më datë 01.03.2017, rezultoi se ky shtetas është sqaruar për rastin edhe nga Drejtuesi i Prokurorisë për Krime të Rënda, z. B. H. Kurse ankesa e fundit e tij, në formën e kallëzimit penal ndaj prokurorëve të Prokurorisë për Krime të Rënda, Besnik Muçi e E. K, është kaluar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me shkresën nr. 161/3 prot., datë 10.03.2017.

Sipas shkresës së Prokurorisë së Përgjithshme: Nga verifikimi në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka rezultuar se është regjistruar kallëzimi penal nr. \*\*\*, datë 12.09.2017, ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Muçi, nga denoncuesi M. L, për të cilin pas verifikimeve, me vendimin e datës 27.09.2017, është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Gjithashtu ka rezultuar se mbi bazën e akteve të ndara nga procedimi penal nr. \*\*\*, datë 10.02.2015, është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, i vitit 2016, për veprat penale... *“Sigurimi i kushteve dhe mjeteve materiale për të kryer vrasje”*, të shtetasit M. L.

Kjo çështje është dërguar për gjykim më datë 10.02.2016 dhe Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.09.2017, ka vendosur deklarimin fajtor dhe dënimin e të pandehurve të mësipërm, me të njëjtat akuza që i ka dërguar për gjykim prokuroria. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.03.2018, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë

### **Hetimi i kryer nga Komisioni dhe arsyetimi ligjor**

Nga verifikimi dhe analiza e kryer nga Komisioni për denoncimin e shtetasit M. L, informacionit dhe praktikës përkatëse të dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. \*\*\*, prot., datë 20.06.2018, duke marrë në konsideratë veçanërisht kërkesën për dërgim në gjyq, datë 10.02.2016, të përpiluar nga subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Muçi, vendimin nr. \*\*\*, datë 18.09.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.03.2018, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, si dhe në bazë të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, të neneve 73 - 76 dhe 78 të ligjit nr. 96/2016, si dhe nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, nuk rezultojnë indice apo prova për paaftësi profesionale të subjektit të rivlerësimit për rastin konkret.

### ***Denoncimi nr. 3***

**Denoncues:** E. M i biri i P. dhe Z., lindur me \*\*\*, në Tiranë dhe banues në Rr. “\*\*\*”, pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, i padënuar më parë, paraqet denoncimin me dosjen, nr. \*\*\*, prot., datë 09.01.2018.

**Objekti i denoncimit:** *“Denoncohet prokurori Besnik Muçi për hetim të njëanshëm në kundërshtim me ligjin, paaftësi profesionale, zvarritje të procesit hetimor”*, bashkëlidhur ankesë 3 (tri) faqe.

Denoncuesi pretendon se akuzohet padrejtësisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, përkatësisht nga prokurori Besnik Muçi dhe prokurori E. K, për kryerjen e disa veprave penale në bashkëpunim me të pandehurit F. K, K. P, A. B etj., duke iu mohuar liria dhe të drejtat themelore.

Ai pretendon se të gjitha akuzat janë ndërtuar mbi disa deklaramë të pavërteta dhe, mbi të gjitha, të pashoqëruara me prova të reja të drejtpërdrejta ose të tërthorta dhe nuk është marrë në pyetje nga prokuroria, siç është marrë disa herë në pyetje K. P, por as nuk është bërë ndonjë ballafaqim me të penduarin K. P, duke i mohuar të drejtën për të dhënë shpjegime.

Prokurori Besnik Muçi, pretendon denoncuesi, ka zgjatur afatin e hetimeve, të kryera këto në kundërshtim me ligjin procedural, jashtë çdo afati të arsyeshëm ligjor dhe logjik.

Denoncuesi kërkon nga Komisioni të hetohet dhe të rishikohen jo vetëm shkeljet e bëra nga ana e prokurorisë, si dhe shkeljet e trupit të gjyqtarëve që gjykuan dhe dhanë vendimin për këtë çështje në gjykatën e shkallës parë në kundërshtim me ndryshimet dhe parashikimet ligjore të Kodit të Procedurës Penale pasi, sipas denoncuesit, gjykata duhej të ndërpriste gjykimin dhe të gjykohej çështja me trup gjykues prej 3 (tre) gjyqtarësh dhe jo me trup të përbërë nga 5 (pesë) gjyqtarë.

Prokurori Besnik Muçi, sipas denoncuesit, ka kryer një sërë shkeljesh të pajustificuara të dispozitave urdhëruese procedurale që kanë sjellë si pasojë shkeljen e lirisë së denoncuesit. Ai pretendon se nuk është marrë në pyetje nga prokurori Besnik Muçi dhe as është dëgjuar ndonjëherë nga oficerët e Policisë Gjyqësore.

***Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. \*\*\*, prot., datë 20.06.2018, ka përcjellë në Komision informacion në lidhje me këtë denoncim kundër subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Muçi, si vijon:***

Në Arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme rezultuan dy ankesa nga shtetasi E. M. Ankesa e parë, datë 16.05.2017, ku ankuesi ka paraqitur disa pretendime lidhur me hetimet e kryera nga Prokuroria për Krime të Rënda, për procedimin penal në ngarkim të tij dhe disa të pandehurve të tjerë. Ky ankim i është kaluar për kompetencë e zgjidhje ligjore Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me shkresën nr. \*\*\*, prot., datë 08.06.2017.

Ankesa e dytë, e cila i është drejtuar edhe Komisionit, Ambasadës Amerikane dhe për dijeni Ministrin të Drejtësisë, është regjistruar në Prokurorinë e Përgjithshme, më datë 09.01.2018. Edhe ky ankim i është kaluar për kompetencë e zgjidhje ligjore Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda me shkresën nr. \*\*\*, \*\*\*, prot., datë 01.02.2018.

Nga verifikimi në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka rezultuar se ankesa e shtetasit E. M lidhet me procedimin penal nr. \*\*\*, të vitit 2016 për veprat penale “...Sigurimi i kushteve dhe mjeteve materiale për të kryer vrasje”, të shtetasit M. L, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit” dhe “Moskallëzim krimi”, parashikuar nga nenet 78/2, 78/2/22, 80, 278/5 dhe 300 të Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurve A. T, K. P, E. M, D. P, A. O, A. Q, A. G, F. K, A. B dhe Dh. Z, si dhe “Krijimi i grupit të strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal” në ngarkim të të pandehurve A. T, K. P, E. Mi, përshkruar në rastin e ankesës së shtetasit M. L.

Në përfundim të gjyimit, denoncuesi është dënuar me vendim të formës së prerë, për veprat penale të parashikuara nga nenet 78/2, 28/4,80 (2 herë), 25, 278/1 e 333/a/1 të Kodit Penal, me 35 vjet burgim.

**Hetimi i kryer nga Komisioni dhe arsyetimi ligjor**

Nga verifikimi dhe analiza e kryer nga Komisioni për denoncimin e shtetasit E. M, informacionit dhe praktikës përkatëse të dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. \*\*\*, prot., datë 20.06.2018, duke marrë në konsideratë veçanërisht kërkesën për dërgim në gjyq datë 10.02.2016, të përpiluar nga subjekti, prokurori z. Besnik Muçi, vendimin nr. \*\*\*, datë 18.09.2017, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.03.2018, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, si dhe në bazë të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, të neneve 73 - 76 dhe 78 të ligjit nr. 96/2016, si dhe

nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, nuk rezultojnë indice apo prova për paaftësi profesionale të subjektit të rivlerësimit për rastin konkret.

*Në përfundim, në vlerësimin në tërësi të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, pas rekomandimit të relatorit të çështjes, bazuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës, nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, e konsideron subjektin e rivlerësimit “të aftë”.*

## **V. VLERËSIMI I ÇËSHTJES NGA TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMI**

1. Trupi gjykues, referuar Aneksit të Kushtetutës (neni D), ligjit nr. 84/2016 (kreu IV), lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludoi se subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Muçi:
  - f) Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
  - g) Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
  - h) Nuk ka kryer deklaram të rremë;
  - i) Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.
2. Referuar Aneksit të Kushtetutës (neni DH), ligjit nr. 84/2016 (kreu V), lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Besnik Muçi, është i përshtatshëm për vazhdimin e ushtrimit të detyrës.
3. Referuar Aneksit të Kushtetutës (neni E), ligjit nr. 84/2016 (kreu VI) dhe ligjit nr. 96/2016, në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “ i aftë”, duke treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve ose viktimave, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme.

Bazuar në këto konkluzione, si dhe nga vlerësimi tërësor i procedurave, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit:

- Ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë (neni 59, pika 1/a, i ligjit nr. 84/2016);
- Ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës (neni 59, pika 1/b, i ligjit nr. 84/2016);
- Ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale (neni 59, pika 1/c, i ligjit nr. 84/2016).

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, dhe në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Besnik Muçi, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.
2. Ky vendim, i arsytuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 01.08.2018.

### **KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Lulzim HAMITAJ**  
**Kryesues**

**Olsi KOMICI**  
**Relator**

**Brunilda BEKTESHI**  
**Anëtar**

Sekretare gjyqësore  
Denisa Kosta